




Në prag të *Ramazanit*



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 03 (468)
Mars, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- | | |
|----|---|
| 4 | Dimensioni social i Ramazanit të sivjetshëm / Dorian Demetja |
| 6 | Agjërimi, disiplinë morale, shpirtërore, fizike e shoqërore / H. Bujar Spahiu |
| 10 | Lajme / Aktivitete |



- | | |
|----|--|
| 14 | Udhëtimet e kthellojnë njeriun / Nuredin Nazarko |
| 16 | Koha për lutje / Ali Zaimi |
| 18 | Të udhëzosh botën / Haki Sahitaj |
| 20 | Jurisprudenca e agjërit / Islam Hoxha |
| 22 | Ramazani, muaji i Kur'anit / Riza Islami |
| 24 | Ndikimi i agjërit në proceset biokimike dhe bioritmike / Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi |



- | | |
|----|--|
| 26 | Hafiz Sherif Langu (1877-1956) / Cemal Rusli |
| 30 | Trashëgimia e madhe e Muhamet Çamit (Kычыкyт) / Shetk Osmani |
| 32 | Të edukosh një fëmijë / Aisa Kokiçi |
| 34 | Farmakokinetika: Organizmi dhe ilaçi / Naim Yilmaz |
| 38 | Babai dhe djali – Hapësirë feminare |



DIMENSIONI SOCIAL I

Ramazanit
të sijetshëm

Për një periudhë dy vjeçare të pandemisë, na ka munguar dimensionin social i Ramazanit. Mirëpo Ramazani i sivjetshëm vjen me një kënaqësi të veçantë, sepse besimtarët do të jenë më shumë të pranishëm mes njëri-tjetrit në çdo lloj forme. Ky muaj është për të gjithë besimtarët më së shumti mënyrë jetese sesa mënyrë mendimi, pasi në këtë muaj është veprimi ai që sundon në të gjitha çastet. Njeriu i afrohet më shumë se kurdoherë tjetër detyrës për të qenë konkret dhe realist për atë që thotë apo mendon.

Muaji i Ramazanit është një muaj i veçantë në jetën e individit mysliman dhe shoqërisë Islame, pasi në të rinovohet krejt jeta! Gjallërohen mendjet me dije dhe njohuri, gjallërohen zemrat me besim dhe përkushtim, gjallërohet shoqëria me bashkëpunim dhe ndërlidhje, gjallërohet vullneti duke garuar njerëzit në bamirësi dhe vepra humane të konsiderueshme.

Muaji i Ramazanit është muaji ku Allahu i shumëfishon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ata në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinqeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti, virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërit në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit.

Muaji i Ramazanit është një rast i mirë për ata të cilët dëshirojnë të gjejnë dhe të vazhdojnë rrugën e udhëzimit, për t'iu afruar Allahut më tepër me vepra të mira, duke harruar armiqësinë, urrejtjen, inatin dhe egoizmin e duke marrë pjesë në tubime ku jepen këshilla dhe adhurohet Zoti Fuqiplotë. Jo vetëm kaq, por duhet të dimë se muaji i Ramazanit, është edhe koha kur zgjojmë dhembshurinë, mëshirën dhe solidaritetin me të tjerët, sidomos me të varfrit, të cilëve duhet t'u gjendemi më afër se kurrë, duke iu përgjigjur nevojave të tyre, sepse në këtë muaj ne vetë e përjetojmë urinë, të cilin i vobekti e përjeton në çdo kohë.

Muaji i Ramazanit njihet si muaj i përkujdesjes. Të përkujdesesh për të tjerët ashtu siç përkujdesesh për vete dhe të ndash me të tjerët lumturinë dhe brengosjen. Përkujdesja është një akt fisnik i besimtarit, që do të thotë të shpenzosh kohë, përpjekje, njohuri, energji, para. Kryerja e veprave të tilla fisnike kërkon njerëz me zemër të madhe.

Në këtë muaj, ndihmesa e anasjelltë, butësia dhe toleranca, duhet të jenë më të pranishme ndërmjet myslimanëve. Në të njëjtën kohë, ndjenjat shpirtërore të besimtarëve gufojnë dhe janë shumë herë më aktive. Kështu, besimtari bëhet më i vetëdijshëm në përjetimin e fesë së tij. Dhe po në këtë muaj, e kupton më mirë momentin kalimtar të kësaj bote të rreme dhe rëndësinë e asaj që është e përjetshme.

Në një hadith, Profeti (s.a.s.) ka thënë: "Për sa kohë që ymeti im do ta mbajë gjallë muajin e ramazanit me adhurim, kurrë nuk do të turpërohet!" Sigurisht, rruga e vlerësimit e

kësaj mundësie, e këtij rasti të dhënë, kalon nëpër mbajtjen gjallë me sa të jetë e mundur e asaj kohe të bekuar si një tërësi e vetme me ditët dhe netët, me syfyrin dhe iftarin, me agjërimin dhe sadakanë, me teravinë dhe Kur'anin, sepse në hadith është vënë kushti, "për sa kohë që ymeti do ta mbajë gjallë muajin e ramazanit me adhurim", kusht që mund të plotësohet vetëm me zbatimin e gjërave të parashtruara më sipër.

Po si duhet ta kalojmë këtë muaj dhe ç'duhet të bëjmë për të mbajtur gjallë muajin e Ramazanit, ditët dhe netët e tij të bekuara? A e kryejmë plotësisht detyrën tonë si nënë dhe baba, si bir dhe bijë, si afarist, si mësues, si nxënës, si drejtues, si nënshtetas?! Mendojmë se specifikat e mëposhtme duhet t'i ketë në vëmendje çdo njeri që beson në Zotin dhe ditën e gjykimit:

Në ditë dhe netë të tilla, duke bërë vetëgjykim, duhet t'i gjejmë se ku i kemi të metat dhe gabimet dhe duhet të bartim shpresën dhe vendosmërinë për t'u bërë më të dobishëm, më të suksesshëm, më prodhimtarë!

Po të na lejojnë kushtet dhe mundësitë dhe po ta kemi shëndetin në vend, është mirë që gjatë gjithë Ramazanit të shkojmë në xhami për të falur namazet me xhemat. Kështu, edhe fitojmë më shumë mirësi, edhe krijojmë mundësinë për t'u takuar dhe përshëndetur në këtë atmosferë të begatshme me njerëzit e mjedisit të vendit të punës dhe lagjes. Ka rëndësi që në ditët dhe netët e Ramazanit të shkojmë në xhami bashkë me fëmijët tanë që janë në periudhën e rritjes. Në kohë të tilla entuziaste, ata e kuptojnë më mirë rëndësinë e solidaritetit, bashkimit dhe unitetit.

Në muajin e Ramazanit, në ditët dhe netët e shënuara të kërkojmë mundësinë për të uruar farefisën, fqinjët e miqtë dhe për të pritur urimet e tyre. Urimet e dyanshme dhe interesimi i dyanshëm për mirëqenien jep mundësinë për të marrë pjesë në gëzimet dhe hidhërimet, në sukseset dhe problemet e njëri-tjetrit.

Në ditët dhe netët e Ramazanit lind mundësia e arritjes më lehtë të pëlqimit të Allahut me anë të namazit, sepse çasti i namazit është momenti kur robi është më afër Zotit. Namazi është dhikri më i madh. Është e dobishme që në këto ditë dhe netë të bekuara të tregohet përkushtim i veçantë për këtë adhurim kompleks.

Në këto ditë dhe netë të bekuara, këndimi i Kur'anit dhe dëgjimi i tij, pjesëmarrja në bisedat me temë nga Kur'ani dhe hadithet, dëgjimi i predikimeve dhe këshillave, ndarja me të tjerët e kësaj atmosfere moralo-shpirtërore, i japin njeriut prehje e kënaqësi. Sidomos meditimi mbi kuptimet e Kur'anit dhe haditheve na i plotëson mangësitë e njohurive në fushën e fesë, duke na siguruar thellimin në këtë drejtim.

Në ditët dhe netët e Ramazanit, duhet t'i lutemi me sinqeritet Allahut që të na mbrojë nga fatkeqësitë bashkimin dhe unitetin kombëtar, sigurinë dhe qetësinë kombëtare, botën Islame dhe tërë njerëzimin. Një botëkuptim i tillë i përfton personit vetëdijen se është një pjesëtar i dobishëm i bashkësisë njerëzore.

Agjërimi

**DISIPLINË MORALE, SHPIRTËRORE,
FIZIKE E SHOQËRORE**



Agjërimi, bazë e Islamit

Baza a instituti i agjërimit në Islam erdhi mbas atij të lutjes. Agjërimi u bë i detyrueshëm në Medine, në vitin e dytë të Hixhretit. Para kësaj Profeti agjëronte me dëshirën e vet, si një devocion, në të dhjetën ditë të Muharremit dhe i urdhëronte, gjithashtu, ndjekësit e vet ta agjërojnë atë ditë, mbasi kishte një ditë agjërimi edhe për Kurejshët bazuar në një thënie të Aishes (Buhari, kapitulli 30, hadithi 1). Origjina e agjërimit në Islam mund të gjurmohet kështu deri në kohën kur Profeti ishte ende në Mekë, mirëpo sipas Ibni Abbasit ndodhi mbasi emigroi në Medine, ku iu tregua se edhe Musai agjëronte të dhjetën ditë të Muharremit për kujtim të shpëtimit të izraelitëve, dhe myslimanët si më të afërt të Musai (a.s.) e bënë si rregull ta agjërojnë atë ditë (Buhari 30: 90).

Një institut i përgjithshëm

Subjekti i agjërimit në Kur'an është zhvilluar vetëm në një vend, domethënë në ajetin 28, kapitulli dy, megjithëse agjërimi është përmendur edhe në raste të tjera me qëllim falje të metash personale e disa herë si fidje. Ky ajet fillon me shënimin që instituti i agjërimit është i përgjithshëm, "O besimtarë! Agjërimi u bë i detyrueshëm mbi juve ashtu sikundër ishte i detyrueshëm për ata para jush, kështu që të mund të ruheni nga e keqja" (2: 183). E vërteta e kësaj shprehje, që agjërimi "ishte i detyrueshëm për ata para jush", dëshmohet edhe nga historia e feve. Ushtrimi i agjërimit ka qenë i njohur pothuaj përgjithësisht në të gjitha fetë e kumtuara, megjithëse e njëjta rëndësi nuk i është dhënë në të gjitha, si dhe format e qëllimet ndryshojnë. "Metodat dhe qëllimet e tyre ndryshojnë shumë sipas klimës, racës, qytetërimit dhe rrethanave të tjera; por kishte për të qenë e vështirë me gjet ndonjë sistem fetar të përmendur që të mos e ketë njohur fare atë." (Encyklopedia Britanica, Art, Fasting).

Kuptimi i dhënë nga Islami

Cruden-i në Librin e tij, Bible Concordance, thotë se agjërimi, në të gjitha kombet mbahesh "në kohë zie, fatkeqësie ose vdekje", e kjo provohet me fakte, mirëpo Islami i ka dhanë këtij ushtrimi një kuptim të lartë e të zhvilluar. Ai refuzoi kryekëput idenë e zbutjes të zemërimit të Zotit, ose për të fituar dashurinë e Tij me anë të vuajtjeve vetëdashëse, dhe i zëvendësoi këto me agjëtime të rregullta e të vazhdueshme, pa marrë parasysh gjendjen individuale e krahinore, si një mjet për të zhvilluar fakultetet e brendshme të

njeriut. Kur'ani flet edhe për agjëtime të tjera si për t'u shkarkuar nga shkela pa dashur e ligjeve Hyjnore megjithatë këto janë krejt të dallueshme nga agjërimi i detyrueshëm i Ramazanit, dhe se janë përmendur si një alternativë ndaj një vepre bamirëse, si p.sh. ushqimi i një të varfri.

Agjërimi në Islam, si një institut, është bërë disiplinë shpirtërore, morale e fizike e urdhrit më të lartë, dhe se kjo është bërë e qartë nga ndërrimi i formës dhe i qëllimit. Duke bërë këtë institut të vazhdueshëm, gjithë idetë e frikës, të fatkeqësisë e të mëkatit janë të përjashtuara, ndërsa qëllimi i tij i vërtetë është treguar qartë duke thënë: që të mund të ruheni (tettekun) nga e keqja". Fjala itteka, e cila do të thotë, me e ruajtur një gjë nga gjithçka që e dëmton ose e plagos, ose me e ruajt nga çdo gjë që është frikë se jep përfundime të këqija". Përveç kësaj fjala është përdorur në Kur'an lirisht në kuptim të përmbushjes të detyrave (4: 1), ku erham (lidhjet fisnore të gjakut) janë quajtur si një objekt i ittekas, ose përgjithësisht si në ittekull-Llahe, ku Zoti është qëllimi i ittekas, e prandaj kuptimi i saj për të gjitha këto raste është një përmbushje e detyrimeve. Në gjuhën e Kur'anit të qenët mutteki, do të thotë, të arrish gradën e zhvillimit më të lartë shpirtëror. "Zoti është miku i Muttekive" (45:19); "Zoti i do Muttekiët" (3: 75); 9: 4, 7); "Zoti është me Muttekiët" (2: 194; 9: 36, 128); "Fundit është i mirë për Muttekiët" (7: 128; 11: 49; 28: 83); Për muttekiët është një vend i shkëlqyer" (38: 49). Këto dhe shumë fraza kësodore dëshmojnë qartë se Mutteki, sipas Kur'anit, është ai njeri që ka arritur shkallën më të lartë të zhvillimit shpirtëror.

Një disiplinë shpirtërore

Agjërimi, sipas Islamit, së pari është një disiplinë shpirtërore./ (9:112 dhe 66:5). Kur'ani, duke folur mbi Ramazanin, i referohet veçanërisht afrimit të Zotit, mbërritja e të cilit është një nga qëllimet e agjërimit e pastaj shton: "Kështu ata lypset t'i përgjigjen thirrjes Time (duke agjëruar) e të Më besojnë që kësaj që të mund të gjejnë rrugën për te Mua" (2:186). Në hadithet profetike, gjithashtu, i është dhënë rëndësi e posaçme faktit që, kënaqësia Hyjnore, lypset të jetë qëllimi i fundit në agjërim: "Cilido që agjëron Ramazanin, duhet të ketë besim në Mua e të kërkojë kënaqësinë Time" (Buhari, 2: 28). Profeti tha "Agjërimi është mburojë, kështu që agjëruesi s'duhet të merret me biseda të kota... sigurisht fryma e një njeriu që agjëron

është më e këndshme te Zoti sesa era e myshkut; ai ndalohet nga ushqimi e pija e nga dëshirat e tjera, vetëm e vetëm që të fitojë kënaqësinë Time: agjërimi është vetëm për Mua” (Buhari 80:2).

S’ka nxitje më të madhe se ajo e të fikurit të etjes e të urisë, kur pija dhe ushqimi janë nën zotërimin e çdonjërit prej nesh e urdhërojmë veten, jo vetëm një herë e dy, por përditë e rregullisht për një muaj të tërë me qëllim për t’iu afruar sa më tepër Qenies Hyjnore. Ndër skutat e fshehta të shtëpisë së tij s’ka kush që ta shohë nëse lag fytin e djegur me një gotë ujë të freskët, mirëpo tek ai është zhvilluar ndjenja e afrimit të Zoti në gradë të atillë që nuk dëshiron të lagë edhe buzën me një pikë ujë. Sa herë që i vjen ndonjë shtytje e keqe ai e mposht, sepse pikërisht në momentin kritik, i thotë një zë nga brenda: “Zoti është me ty; Zoti të sheh”.

Një disiplinë morale

Në agjërim gjithashtu shtrihet edhe disiplina morale, sepse është fusha ku njeriut i mësohet morali i lartë i kësaj jete sprove që ai duhet të përballojë për të duruar mundimin më të madh vetëm e vetëm që të mos zhjyhet në atë që është e lejueshme për të. Ky mësim përsëritet për çdo ditë gjatë një muaji të tërë; dhe pikërisht sikur ushtrimi fizik që zhvillon njeriun fizikisht ashtu edhe ushtrimi moral, me anë të agjëritit e të frenimit, forcon anën morale të jetës së tij. Qëllimit, që çdo gjë e paligjshme lypset të shkëlmohej dhe e keqja duhet të urrehet, i mbërrihet vetëm me anë të agjëritit. Një tjetër pikëpamje e zhvillimit moral të njeriut, me anë të këtij mjeti, është se në këtë mënyrë, ai stërvitet për të mposhtur dëshirat e tij fizike dhe lakmitare. Ai ha ushqim në intervale të rregullta, e s’ka dyshim se kjo është e dëshiruar edhe nga rregullat e jetës, për faktin se agjërimi një muaj në vit, i jep atij mësimin më të lartë. Ai në vend që të jetë skllavi i lakmive e i epsheve, bëhet zotëruar i tyre e kështu i aftë për të mbajtur rrugën e drejtë në këtë jetë kalimtare. Njeriu, që është bërë i zoti të kontrollojë dëshirat e tij, bën që fuqia e vullnetit të tij të zhvillohet kaq shumë sa mund të

urdhërojë lirisht vetveten e kështu t’ia arrijë madhështisë së vërtetë morale.

Vlera shoqërore e agjëritit

Përveç vlerave shpirtërore e morale, agjërimi, siç përshkruhet në Kuran, ka gjithashtu edhe një vlerë shoqërore shumë më efektive se ajo që realizohet me anë të namazit. Në këtë të fundit, i pasuri e i varfri, i madhi e i vogli (në gradë), të gjithë mbledhen në faltore, pesë herë në ditë, me kondita plotësisht të barabarta, e kështu themelohen marrëdhënie të shëndetshme shoqërore. Mirëpo me t’u parë hëna e Ramazanit, është shenjë e një lëvizjeje të përgjithshme drejt barazimit, e cila nuk është e kufizuar vetëm në një pjesë ose krahinë, por përmbledh krejt botën myslimane. Pasaniku e i vobekti mund të rrinë gju më gju në një rresht brenda në xhami, por në shtëpitë e tyre jetojnë në kondita të ndryshme. I pasuri ulet në sofër ose mbi tryezë të mbushur me plot të mira dhe ngop barkun nga 4-5 herë në ditë, ndërsa i varfri nuk mund të gjejë ushqim as sa për të shuar tamam urinë qoftë edhe dy herë në ditë. Ky i fundit ndjen gërryrjen e urisë, gjë që i pari nuk e njeh fare, atëherë si mundet i pasuri të ndjejë e të simpatizojë të papasurin? Kësisoj ekziston një pengesë e madhe në mes të dy klasave në shtëpitë e tyre, dhe se kjo pengesë zhduket vetëm kur i pasuri detyrohet të ndjejë dhimbjen e urisë sikur vëllai i tij më i varfër e të kalojë pa ngrënë gjatë ditës, e se kjo provë do të përshkojë jo vetëm një ditë ose dy, por një muaj. Në këtë mënyrë i pasuri e i varfri, në gjithë botën myslimane, vihen në barazi të plotë, në atë që do të hanë vetëm dy herë në 24 orë në ditë, megjithëse gjellët mund të mos jenë njëlloj, por i pasuri së paku detyrohet t’i shkurtojë e të adoptojë thjeshtësinë e ushqimit që bën vëllai i tij i vobektë. Kjo rrugë ngjall, pa dyshim, një simpati të veçantë në zemrat e pasanikëve ndaj të varfërve, dhe është kjo arsyeja që jemi urdhëruar për t’i ndihmuar më tepër nevojtarët, veçanërisht gjatë Ramazanit.

Vlera fizike e agjëritit

Sado që mund të tingëllojë si paradoks ngelja pa ngrënë gjatë intervaleve





të ditës, mirëpo kjo shton shijen e të ngrënit. Pushimi për një muaj i organeve të tjerat u jep atyre fuqi të re porsì një tokë që lihet djerr, e nga pushimi që bën bëhet më prodhuese. Po kështu gjithë organet e trupit janë bërë në mënyrë që vetëm shlodhja u shton aftësinë e tyre për punë, e sa më mirë të jetë aftësia e organeve të tretjes, aq më e shëndetshme vjen rritja fizike e njeriut.

Agjërimi ka edhe një vlerë tjetër fizike e ndoshta më të rëndësishme. Njeriu, që nuk mund të përballojë vështirësitë e jetës, sikur qëllon shpesh, pa konfortet e zakonshme, nuk mund të thotë se është i përshtatshëm për luftën e kësaj bote. Çasti që njeriu i tillë bien në vështirësi ose mungesë, sikurse mund të ndodhë shpeshherë, fuqia e tij është e pjerrun të dështojë. Pra, në këtë rast, agjërimi e mëson atë të përballojë fatkeqësitë e jetës, i jep një mësim praktik, me të cilin shton fuqitë e tij të qëndrimit drejt atij qëllimi.

Muaji i Ramazanit

Me disa përjashtime që do të përmenden më poshtë, myslimanëve iu duhet të agjërojnë për 29 ose 30 ditët e muajit të Ramazanit. Numri ekzakt varet në pamjen e hënës, e cila mund të duket mbas 29 ose 30 ditësh. Agjërimi fillon me hënën e re të Ramazanit dhe mbaron me dukjen e hënës së re të muajit Shevval. Përcillet se Profeti (a.s.) ka thënë: “Ne jemi një popull që as nuk shkruajmë as nuk mbajmë llogari për sa i përket këtij, pse muaji është kështu e kështu, duke i treguar me gishta një herë 29 e një herë 30” (Buhari, 30: 13).

Një hadith tjetër thotë: “Profeti kur përmendi Ramazanin tha: mos agjëroni deri sa ta shihni hënën e re, dhe mos e ndërpreni deri sa ta shihni prapë atë, e nëse ka re llogariteni lënien e saj” (Buhari, 30: 11 dhe Muslimi, 13:2). Një tjetër hadith thotë se, në qoftë qielli me re tridhjetë ditë duhet të plotësohen (Buhari, 30:11).

Zgjedhja e Ramazanit

Urdhri i Kur'anit që flet mbi agjërimin në Ramazan është si vijon: “Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ishte kumtuar Kurani, udhëheqës i njerëzimit

e provues i qartë ei udhës e i dallimit; prandaj kushdo prej jush që dëshmon ardhjen e këtij muaji, duhet ta agjërojë atë” (Bekare, 2:185). Siç mund të kuptohet nga fjalët e urdhrit zgjedhja e këtij muaji të posaçëm për agjërim nuk është pa arsye. U zgjodh për shkak se është muaji në të cilin ishte kumtuar Kur'ani. Dihet fare mirë se ky Libër i Shenjtë ishte kumtuar pjesë pjesë gjatë një periudhe prej 23 vitesh, prandaj me zbulimin e tij në muajin e Ramazanit ka qëllim se revelata e tij e parë filloi në atë muaj, dhe se kjo historikisht është e vërtetë. Ky është muaji që dëshmon eksperiencën më të madhe shpirtërore të Profetit e në këtë mënyrë ishte konsideruar si muaji më i përshtatshëm për disiplinën shpirtërore të botës myslimane.

Ka shumë arsye për zgjedhjen e një muaji hënor. Ky i fundit viziton të gjithë stinët e se vështirësitë e dobite pjesëtohen nga krejt bota. Një muaj diellor mund t'i kishte dhënë dobi vetëm një pjesë të botës me ditët e shkurtra e me klimën e ftohtë, ndërsa pjesën tjetër do ta ngarkonte me vështirësitë e ditëve më të gjata dhe klimës më të nxehtë. Muaji hënor është më i përshtatshëm me natyrën e përgjithshme të mësimave islame dhe se gjithë popujve u takon t'i shijojnë avantazhet që mund të rrjedhin nga kjo nga ana tjetër, po të ishte caktuar një kohë e posaçme, disiplina do të kishte humbur krejt vlerën e saj. I detyrohet zgjedhjes të një muaji të caktuar që me ardhjen e tij krejt bota myslimane vihet në lëvizje, si të thuash, nga një korrent prej një skaji e deri në atë më të largët. Lëvizja që sjell ardhja e Ramazanit në botën myslimane, është turma më e madhe mbi sipërfaqen e tokës. I pasuri e i varfri, i nalti e i ulëti, zotëria e shërbëtori, sunduesi e i sunduari, i ziu e i bardhi, myslimani i Evropës ose i Lindjes së Largët, nga njëri skaj i dheut në tjetrin, menjëherë ndërrojnë mënyrë e jetesës kur ata e shohin me sy hënën e Ramazanit si drapër i hollë që duket nga ana e perëndimit. S'gjendet mbi sipërfaqe të tokës një shembull lëvizjeje e popullit në grup në një shkallë kaq të madhe, dhe kjo i detyrohet muajit të Ramazanit.

Human Fraternity Vëllazëria në Humanizëm



1

ZHVILLOHET KONFERENCA NDËRFETARE ME TEMË: "VËLLAZËRIA NË HUMANIZËM"

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSH) në bashkëpunim me "Religions for Peace, Europe" zhvilluan me datë 10. 02. 2022, në ambientet e "Tirana International Hotel" konferencën ndërfetare, me temë: "Vëllazëria në Humanizëm".

Fokus i kësaj konference ishte dokumenti mbi "Vëllazërinë Njerëzore" nënshkruar nga Imami i Madh i Al-Az'har-it, Ahmad Al-Tayyeb, dhe Papa Françesku në vitin 2019.

Konferenca mbledhi së bashku krerët e 5 komuniteteve fetare zyrtare të vendit, si H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Mons. Angelo Massarfa, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, z. Anastas Janullatos, Kreu i Kishës Ortodokse, z. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH dhe njëkohësisht zv/president i RfP, Europe, si dhe drejtues institucionesh, klerikë, akademikë, studiues dhe personalitete të fushave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit tonë.

Po ashtu kjo konferencë mbledhi sëbashku edhe emra të spikatur në fushën e diplomacisë dhe dialogut ndërfetar, siç ishin Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Yuri Kim dhe i ftuari i nderit, Presidenti i "Religions for Peace, Europe", Dr. Luigi De Silva.





2

TAKIM ME ZËVENDËS AMBASADORIN E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Zëvendës Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Demian Smith, u prit në një takim nga kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Kryetari Spahiu i uroi z. Smith mirëseardhjen dhe e uroi për detyrën!

Bashkëpunimi i ngushtë që ekziston midis Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë ishte tema kryesore e bisedës.

Kryetari e njohu zv/ambasadorin me historikun e KMSH-s, pavarësinë e institucionit, i cili vitin e ardhshëm kremton 1 shekull mëvetësi, si dhe kontributin e çmuar që ka dhënë dhe jep Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në harmoninë ndërfetare në Shqipëri.

Z. Smith falenderoi z. Spahiu për mikpritjen dhe shprehu vlerësimin e tij për liderhipin që ai ka treguar në cilësinë e Kryetarit të KMSH-s. Gjithashtu ai vlerësoi shumë rolin që Komuniteti Mysliman luan në bashkëjetesën ndërfetare në Shqipëri, si dhe shprehu bindjen se pavarësia e institucioneve fetare është shumë e rëndësishme për lirinë e besimit dhe mbarëvajtjen e kësaj bashkëjetese.

3

TAKIM ME AMBASADOREN E SUEDISË

Ambasadorja e Suedisë në Shqipëri, znj. Elsa Hastad, vizitoi Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Znj. Hastad u prit nga Kryetari i KMSH-s, H. Bujar Spahiu.

Kryetari e falenderoi ambasadoren për vizitën dhe vlerësoi mardhëniet shumë të mira midis KMSH dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë.

Fokusi i bisedës ishte miqësia midis dy vende tona dhe intensifikimi i mardhënieve dypalëshe në fushat me interes të përbashkët.

Ambasadorja falenderoi kryetarin Spahiu për kontributin e vazhdueshëm që jep, ai personalisht, dhe KMSH-ja në përhapjen e mesazhit të drejtë dhe paqësor të Islamit. Gjithashtu ajo vlerësoi edhe kulturën e bashkëjetesës fetare në Shqipëri dhe rolin tepër të rëndësishëm që luan Komuniteti Mysliman në të.





4

SIMPOZIUMI ME TEMË "KURANI DHE NJERIU"

Në ambientet e Akademisë së Shkencave, u zhvillua simpoziumi me temë "Kurani dhe Njeriu", kolana e autorit Xhemal Balla botuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (Drejtorja e Kulturës).

Të pranishëm në këtë simpoziium ishin autori i kolanës, z. Xhemal Balla, Kryetari i KMSH-s, H. Bujar Spahiu, Kryegjyshi Botëror Bektashi, H. Dede Edmond Brahimaj dhe Sheh. Bujar Horasani Tarikati Kadri dhe Sheh Qemaludin Reka Tarikati Rufai.

"Profesori Xhemal Balla i përket asaj gjenerate të medresistëve që u mbujtën me kulturë të gjerë fetare e sociale, e ruajtën dhe vunë në jetë dijen që morën në medrese.

Ai është edhe një ndër kontribuesit kryesorë në lëmin e literaturës fetare e cila i shërbeu ringritjes së islamit në Shqipëri pas viteve '90.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është krenar për bashkëpunimin që ka patur në fushën e botimeve me autorin Xhemal Balla."- u shpreh Kryetari Spahiu gjatë fjalës së tij përshëndetëse.

Ndërsa Drejtori i Kulturës, z. Demetja, gjatë fjalës së tij tha se kjo kolanë vjen si botim i KMSH-së me 10 vëllime.

Simpoziumin e përshëndeti edhe Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, Kryegjyshi Botëror Bektashi, H. Dede Edmond Brahimaj dhe Sheh. Bujar Horasani, të cilët vlerësuan dobinë e këtyre botimeve për besimtarët në veçanti, por edhe për publikun e gjerë.

Të pranishëm në simpoziium ishin shumë besimtarë, intelektualë e dashamirës të librit.





5

FRYTET E BESIMIT NË XHAMINË E ET'HEM BEUT

Frytet e Besimit u ndalën të enjten mbrëma në Xhaminë Et'hem Beu në kryeqytet.

Në kuadër të hyrjes në 3 muajt e begatë, përveç imamit të Xhamisë, Elton Karaj, nënkryetarit Bica, ishte i pranishëm edhe Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu.

Në një ambient të ngrohtë midis besimtarësh, u këndua Kur'an, u nda me besimtarët rëndësia e këtyre muajve në jetën e besimtarëve. "Të dashur besimtarë, këto muaj janë një begati e madhe për ne. Janë një mundësi për një pastrim shpirtëror dhe faljeje, me lejen e Zotit (xh.sh).

Këta muaj janë të atillë që, nëse lutemi me sinqeritet, jemi të përpiktë me urdhërat e Allahut (xh.sh.), marrim shumë sevape dhe begatohet jeta jonë, na mbron inshAllah Zoti nga fenomene që prekin dobësinë njerëzore.

Janë muaj që na japin mundësinë të ridimensionojmë jetën tonë shpirtërore dhe shoqërore.

Ta lusim Zotin e gjithësisë të na bëjë të mundur të përfitojmë të gjitha mirësitë dhe bereqetin e këtyre muajve!"- tha kryetari Spahiu ndër të tjera në fjalën e tij.

6

PËRURUHET QENDRA KULTURORE NË BARBULLUSH TË SHKODRËS

Nën një ceremoni të ngrohtë shpirtërore është përfunduar ditën e djeshme në Barbullush të Shkodrës, qendra kulturore pranë xhamisë së këtij fshati.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, Drejtori i Vakf-Investimeve dhe Financës në KMSH, z. Edison Hoti, Myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, drejtuesi për Ballkanin i fondacionit "Rahmeh International" në Kuvajt, z. Isa Dhewadi, drejtori i fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, drejtori i fondacionit "Mirënjohja", z. Samed Shehu, si dhe dhjetëra imamë dhe besimtarë të zonës.



Mbëthëtimet E KTHJELLOJNË NJERIUN



Nata ishte në të rënë. Yjet e para sapo kishin nisur të shfaqeshin në horizontin që po humbte me shpejtësi përskuqjen e zbehtë të perëndimit. Udhëtimet nuk e lodhnin asnjëherë, madje mezi priste të niste ndonjë udhëtim të ri ende pa mbaruar udhëtimi në të cilin gjendej. Qetësia e udhëtimit gjithmonë i jepte mundësi të reflektonte thellësisht. Ishin orë të cilat nuk e shqetësonte asgjë tjetër veç kërcimit degë më degë në pemën e kujtesës. Kaloj para syve kronologjinë e asaj pjese të kohës fizike që kishte kaluar mbi sipërfaqen e tokës. Ende nuk dinte se cilën pjesë të vlerësonte më shumë, atë që kishte ikur apo atë që pritej të vinte. Ishte në gjendje pezull. Çfarë kishte përjetuar e analizoi për një kohë krejt të shkurtër. Vite të tëra jete ishin përmbledhur në një pjese kohe që nuk do t'i mjaftonte as të gjerbte një kafe. Ngjarjet e jetës herë i dukeshin të largëta, të zbehta e të megjulluara, e herë të freskëta, plot gjallëri e jetë sikur të ishin duke ndodhur bash në çastet që ishte duke udhëtuar. Në errësirën e natës përfytyrimet bëheshin të gjalla. Mistika e saj ishte thellësisht jetëdhënëse për ndërmendjen e sa e sa ngjarjeve që kishin prekur e lënë gjurmë në shpirtin e brishtë e të fortë të asaj krijese njerëzore.

Rruga herë dredhonte e herë ishte e drejtë. Herë ngjitej nëpër qafa malesh e herë zbriste në lugina. Diku shfaqeshin grumbuj pemësh. Më tej shkëmb i zhveshur e i thepisur. Pastaj pyje që shtriheshin tej në horizont. Fusha diku të pluguara e diku të lëna djerrë. Askund përgjatë udhëtimit nuk hasi dy herë të njëjtën pamje. Kjo e bënte udhëtimin tërheqës. Gjithmonë ishte në pritje të asaj që do të shfaqej në dredhimin, ngjitjen apo zbritjen e rradhës. E gjithë qenia pushtohej nga emocioni. Sapo e panjohura bëhej e njohur fërgëllimi i zemrës merrte fund dhe vendin e emocioneve e zinte analiza racionale e ngjarjeve për t'i shtrëdhur deri në pikën e fundit mësimet që dilnin prej tyre.

Lidhjet shkak – pasojë, pastaj pasoja që bëheshin shkaqe të të tjerave pasoja formonin një zinxhir të gjatë analize që herë bëhej i lodhshëm, i mërzitshëm e

sfilitës, e herë i gjallë e plot emocion. Në atë zinxhir qëndronte jeta e tij, që lëkundej sipas ritmikës së shpejtësisë apo ngadalësisë së udhëtimit. Qoftë shpejtësia apo ngadalësia në udhëtim nuk ishin nën urdhërin e dëshirës së tij. Të ishte për të do të udhëtonte me shpejtësinë e dritës e do t'i binte cep më cep universit e nuk dihej në do të kthehej a jo prej këtij udhëtimi. Por ashtu i kufizuar si ishte, në fuqi, mendime e veprime, përçapej të bënte aq sa mundej deri në limitin e fundit të mundësive të tij. Vazhdimisht ishte i shqetësuar se a kishte mundur të jepte maksimumin e vet në këtë udhëtim të përkohshëm? Mos vallë kishte patur mundësi t'i jepte jetës më shumë nga sa i kishte dhënë deri më tani prej energjisë së vet? Mos vallë po mashtronte vetveten duke e bërë të besonte se kishte dhënë gjithçka mundej në këtë jetë e tashmë nuk i mbetej më asgjë për të dhënë? Nëse nuk kam asgjë për të dhënë atëherë është koha të shkoj, i shkrepiti befaz në kokë.

Udhëtimi vazhdonte i qetë në terrin e natës, ndërkohë që brenda qenies së tij jeta udhëtonte me të gjitha përmasat e saj. Diku një ndalesë dhe sinjali që duhej të merrnin një pushim e zgjoi nga ai udhëtim i gjatë jetësor. Gjysmë i mpirë nga ndenja për një kohë të gjatë në të njëjtin pozicion, u përçap ngadalë. Ajri i ftohtë i natës iu mbështoll rreth qenies duke i rrahur fytyrën dhe qepallat. Sytë i përshkënditën. Mushkëritë u zgjeruan nga oksigjeni i pastër. Disa çaste pushimi dhe iu ripërtërinë energjitë. I la mënjanë mendimet në vullkanin e tyre dhe shijoi një copë herë paqen e natës. Sa do të donte të zgjaste kjo paqe, por duhej hipur në mjetin e udhëtimit. Kishte ende kohë për të udhëtuar. Kohë për të menduar dhe vlerësuar jetën me të gjitha ngjyrat e saj. Udhëtimi sa vinte dhe bëhej më i shkurtër. Po shkohej drejt pikës së fundit ku edhe po të donte nuk mund të ndalej. Mjeti ndali dhe u dha shenja që tashmë ishte rikthyer në shtëpinë e parëhershme. Tashmë e kuptoi që i gjithë udhëtimi nuk paskësh qenë as më shumë e as më pak vetëm se përmallim. Përmallim për t'u rikthyer në strehën e lënë prej kohësh.

KOHA PËR LUTJE

Është koha për duá. Është koha për të ngritur duart e të lutemi si kurrë më parë. Momentet që po jetojmë na nxisin të lutemi siç na nxit hyrja e Ramazanit të agjërojmë, siç na nxit ezani të falemi. Retë e zeza mbi qiellin njerëzor na shtrëngojmë të hapim çadrat e turpit, të pendesës e të trishtimit për sojin njerëzor. Ndërsa ndjekim, edhe pse nga larg, krimet çnjerëzore mbi më të pafajshmet krijesa, fëmijët, na rrëqethen zemrat sikur t'i kishim përpara syve, sikur t'i preknim e t'u kërkonim falje në emër të njerëzores, që për një çast po bën edhe njëherë një betejë të ashpër për ekzistencë...

Është koha për duá. Sepse duája është çelësi i thesareve të pashtershme të Krijuesit, është streha më e sigurt e besimtarit. Teksa vëzhgojmë gjendjen e njerëzve të besimit përballë sfidave dhe intrigave të kohës, komplotet dhe kurthet që luhen mbi ta, reagimi që të vjen më natyrshëm është ndoshta një klithmë, një "Oh" që del nga thellësia e shpirtit e pasuar me një tjetër klithmë: "O Zot!..."

Është koha për lutje. Sepse Islami, feja jonë e bukur,

drita e syve tanë, bota jonë e shpirtit kurrë më parë nuk është keqinterpretuar dhe keqkuptuar më shumë sesa tani. Sado e rëndë të jetë për ta pranuar, faktet kokëforta, përtej zullumit dhe pengesave të "armiqve", tregojnë se ne si besimtarë nuk kemi mundur t'ia shpjegojmë botës si duhet madhështinë e Zotit të gjithësisë, Profetin e mëshirës, fenë e paqes, mesazhin e harmonisë, vëllazërisë, sinqeritetit. Ndaj, në këtë gjendje të rëndë ku gjendemi si besimtarë, ndoshta më e para strehë ku duhet të vrapojmë është duája. T'i kërkojmë Zotit falje për mëkatet që s'kanë të sosur; t'i kërkojmë Zotit falje për mirësitë ndaj të cilave kemi qenë mosmirënjohës, t'i kërkojmë falje Zotit për gabimet që s'kanë të mbaruar. T'i kërkojmë falje që për shkakun tonë njerëzit në vend që të afrohen, ndoshta janë larguar nga feja, ose kanë qëndruar larg saj sepse përfaqësimi ynë i gabuar i ka trembur. T'i kërkojmë falje Mëshiruesit që e kemi prezantuar veten gabim, jo si njerëz të paqes, të tolerancës, të mirëkuptimit, të zemërgjerësisë, të mëshirës, të dashurisë, por si turma

të pafata të larguar prej këtyre vlerave që paraardhësit tanë i patën trashëguar brez pas brezi e ne nuk po dimë t'i ruajmë ato.

Ndoshta askush s'ka të drejtë të jetë i ashpër me njerëzit e besimit. Ndërsa shkruaj këto rreshta dridhem mos t'i hyj në hak mijëra apo miliona njerëzve që përpiqen me mish e me shpirt të jenë përfaqësues të denjë të normave të besimit, por, kur shikon ngjarjet e dhimbshme në gjeografinë ku jetojnë kryesisht myslimanët, është e pamundur ta mbash veten. Ajo që të trishton më tepër është kur njerëzit e besimit, myslimanët bëhen pjesë e zullumit, padrejtësive, trazirave, rrënimit; madje kur disa të mjerë pretendojnë t'i kryejnë këto paudhësi në emër të fesë, kjo të pikëllon pa masë. Dhe pyes: me ç'të drejtë ata përpiqen ta përziejnë faqen e ndritur të Islamit me tekat e tyre. A janë besimtarë këta njerëz? A janë të përdorur? Të mashtruar?...

Për të mos i pasuar gabimet me gabime e zullumin me zullum, për të mos i shtuar gjynaheve gjynahe e rrënimit rrënim, ndoshta i vetmi hap që na ngelet të hedhim, dhe gjykoj më i domosdoshmi për momentin është duaja, është lutja e singertë, është përgjërimi, sikurse na e kanë mësuar të parët, me dorë në zemër.

Është koha për lutje, sepse lutja në vetvete është një tregues dhe domosdoshmëri e besimit, ku njeriu, duke paraqitur gjendjen e tij nevojtare, me përlulësi e respekt kërkon prej të Gjithëmëshirshmit çfarëdo që kërkon.

Në këto ditë, kur gjithë këto intriga, komplete e kurthe qëndrojnë përpara besimit si kurthe tinëzare, ka një nevojë emergjente për duá. Ka nevojë për duá dhe përgjërëm sa të dridhen zemrat e sytë të lotojnë rrëke. Sa më shumë njerëz të luten për diçka aq më shumë mundësi ka që Zoti ta pranojë atë. Kur Hz. Musai (a.s.) pati kërkuar rrugëdalje nga telashet që kishin shkaktuar një grup prej popullit të tij, Allahu i pati mësuar që të pendoheshin e të luteshin të gjithë së bashku për mëkatet e tyre.

Le t'i kërkojmë pra falje Allahut, të gjithë së bashku, së pari për gjynahet tona e më pas për të paudhët, për shkatërrimtarët dhe mizorët. T'ia lëmë në dorë Allahut që t'i ndryshojë e t'u pastrojë gjynahet edhe atyre, nëse nuk kanë aftësi të pastrohen të bëjë atë që do dhe di Ai. Ai është Gjykuesi më i Drejtë.

Le t'i kërkojmë falje Atij që di atë që shprehim dhe çfarë ne fshehim:

Zoti ynë, mos lejo që zemrat tona të devijojnë tani, pasi na ke udhëzuar. Por na dhuro mëshirë prej pranisë Tënde, sepse Ti je dhuruesi më i madh.

Zoti ynë i Madh, ne vetëm Ty të besuam, e vetëm te Ty mbështetemi. T'u drejtuam ty me tërë fuqinë e shpirtit, dhe e dimë që në fund, përballë Teje do të vijmë.

Zoti ynë i Lartësuar, mos na lër ne vetëm për vetëm me sprovën e mohuesve! Na fal neve, sepse padyshim që Ti je i Shenjtë e i Urtë.

Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë. Zoti ynë, mos na ngarko neve ngarkesa si iu ngarkove

atyre para nesh. Zoti ynë, mos na ngarko mbi atë që ne kemi forcë të mbajmë.

Zoti ynë, ne i kemi bërë padrejtësi vetes. Nëse Ti nuk na fal dhe mëshiron, me siguri do të jemi prej të humburve.

Ne jemi të padrejtë, të rrënuar dhe të shkatërruar. Si myslimanë kurrë në histori nuk kemi qenë kaq larg Teje. Kurrë nuk kemi hyrë në thellësi të tilla të dështimit. Kurrë nuk kemi qenë kaq pa Ty. Na dërgo një fllad shprese prej mëshirës Tënde. Na e ndrysho këtë gjendje mjerimi.

O strehë Burimi për të mjerët, O posedues i ilaçit për të sëmurët dhe udhëzues i qartë për të humburit! Ne të braktisëm Ty dhe u dalldisëm drejt botës. Gjatë kësaj kohe askush nuk i hapi dyert për ne. Mendimet tona u quajtën krime, ndjenjat tona u përbuzën dhe u përqeshën, veprimet tona u dënuan deri sa ne të kuptojmë se s'ka strehë tjetër veç derës së Mëshirës Tënde.

Por, Zoti ynë! Ne e dimë që deri më tani, asnjë nga ata që kanë pritur pranë derës Tënde nuk janë kthyer duarbosh, por janë kthyer prej aty me bekim prej Teje, të falur, të mëshiruar, të udhëzuar e plot shpresë. Prandaj të kërkojmë me përgjërëm: hapi portat e faljes dhe mëshirës.

Dërgo një dritë nga prania Jote për ata që vuajnë në errësi, sidomos këto ditë, kur rrethanat sociale janë në çrregullim të plotë; kur zërat e tiranëve dëgjohej kudo. Shuaj zjarrin e tiranisë dhe padrejtësisë me fuqinë tënde të pafund. Na jep një ilaç për të gjitha fatkeqësitë që kemi vuajtur për shekuj me radhë. O më i Mëshirshmi, Më i Dhembshuri, pranoji lutjet tona!

O Zot i Mëshirës dhe Faljes, forcoji zemrat tona në fe. Mbushi zemrat me besim. Udhëzونا ne, familjet tona, shoqërinë tonë! O i Dashur, dhurues i dashurisë, furnizoji zemrat tona me dashuri e mëshirë! Pastroji zemrat tona nga urrejtja, smira, xhelozia, armiqësia dhe çdo e keqe. O Zot, dhuroi vendit tonë paqe, begati e mirësi dhe mbroje nga çdo rrezik e fatkeqësi...

O Zot, dhuroji botës paqe e qetësi.

Përpos kësaj duaje të shkurtër, çdo besimtar mund të lundrojë në oqeanin e ndjenjave të veta dhe t'i lutet Zotit me sinqeritet dhe besim të plotë. Le t'i lutet, tani është koha për lutje.

Është koha për lutje sepse në kopshtin e myslimanëve ka pllakosur zia e përçarjes, e varfërisë, e injorancës, e egoizmit, e dëshirës për famë, për pushtet e për t'u duartrokatur. Listës së këtyre armiqve të botës sonë shpirtërore tashmë i janë bashkëngjitur edhe mashtrimi, detyrimi me forcë, ekstravaganca, pandjeshmëria, indiferenca dhe ndotja intelektuale.

Është koha për lutje që të mbarojë mizoria e mizorëve, tirania e tiranëve, çmenduria e dëshirave pa fre të kësaj bote. Është koha për duá që të rikthehet buzëqeshja në buzët e jetimëve, të pastrehëve, nevojtarëve, të ndizet shpresa në zemrat e të dhunuarve, të shtypurve të vuajturve...

Është koha t'i lutemi Atij që i dëgjon lutjet, Atij që i përgjigjet kërkesave tona!

TË UDHËZOSH BOTËN

"Muslimani nuk është krijuar që të shkojë sipas rrymës dhe të ecë nga të fryjë era, por ai është krijuar që të udhëzojë njerëz."

Muhammed Ikbal

Jeta jonë merr një drejtim brenda një botëkuptimi që ne e kemi pranuar si rrugën e duhur për të përmbushur fatin tonë. Në fund të fundit, të gjitha fetë kanë synuar t'i japin njeriut këtë përgjigje. Muslimani ka një vizion me anë të të cilit e orientojnë tërë jetën e tij. Qëllimi i jetës është përcaktuar nga shpallja hyjnore e cila i është shpallur të dërguarit, Muhamedit (a.s.). Muhamedi (a.s.) njëherësh ishte edhe njeriu i parë i cili e trupëzoi këtë shpallje, e orientoj shoqërinë e kohës së tij dhe iu qas sfidave të kohës së tij pikërisht sipas udhëzimeve të kësaj shpalljeje. Historinë, prej kësaj periudhe e përcaktuan personalitetet muslimane. Kjo pasi, të qenit musliman do të thoshte të jetoje brenda ligjeve dhe harmonisë që e udhëhiqte botën. Megjithatë, kjo vetëdije e muslimaneve dalëngadalë zuri të zbehej. Tashmë të tjera forca, botëkuptime dukej se përcaktonin fatin e historisë. Allahu në Kur'an na ka treguar se vazhdimisht ka pasur forca të tilla të cilat ndonëse kanë treguar ngritje të fuqisë materiale, përsëri atyre u janë dërguar peygamberë në mënyrë që të paralajmërohen se vizioni i tyre mbi veten dhe botën është i gabuar. Në rast se ata do vazhdonin në këtë mënyrë, përfundimi i tyre do ishte shkatërrimi.

"Kush është më i fortë se ne?" (Fussilet, 15)

"Ne i kishim bërë ata më të fuqishëm se ju dhe u kishim dhënë atyre dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por as dëgjimi i tyre, as shikimi i tyre e as zemra e tyre, nuk u sollën kurrfarë dobie, sepse mohuan shpalljet e Allahut; ata i goditi ajo me të cilën talleshin." (Ahkaf, 26)

Shumë nga këta popuj nuk u vinin veshin udhëzimeve të peygamberëve.

"Populli i Nuhut, i quante gënjeshtarë të Dërguarit." (Shuara, 105)

"Fisi Ad i quante gënjeshtarë të Dërguarit." (Shuara, 123)

"Edhe fisi Themud i quante gënjeshtarë të Dërguarit." (Shuara, 141)

Por siç na tregon edhe Kur'ani, bindjet e tyre bazoheshin në zotat që ata adhuronin. Ata mendonin si ishin në rrugë të drejtë. Ata mendonin se pushteti i tyre ishte falë rrugës që ata ndiqnin, idhujve që adhuronin, prandaj dhe Allahu në një ajet thotë:

"Idhujt, që ata i adhuronin në vend të Allahut, nuk i ndihmuan aspak, kur erdhi urdhri i Zotit tënd dhe nuk iu shtuan atyre kurrgjë tjetër, përveç humbjes. (Hud, 101)

Pejgamberët janë ata të cilët kishin ardhur me misionin për të udhëzuar njerëzit, për t'u treguar mënyrën e vërtetë të jetuarit, për t'i kuptuar siç duhet sekretet e jetës. Pushteti, fitoret e mëdha nuk ishin kritere të mjaftueshme për të menduar se ishin në rrugë të drejtë. Por çdo gjë ka kohën e vet.

Në ditët e sotme shohim se shumë muslimanë ndjehen të padobishëm përballë fuqisë që zotërojnë persona dhe shtete të ndryshme. Shpesh ky dëshpërim vjen nga pamundësia për të qenë pjesëmarrës në këtë pushtet. Forcat dhe drejtimet e ndryshme në kohën tonë janë të shumta. Ato flasin dhe e legjitimojnë veten e tyre gjithmonë në emër të së ardhmes, për të mirën e të gjithëve, gjithmonë duke na treguar se kush jemi ne.

"Por 'e ardhmja' është një fushë e kontestuar ku fetë e vjetra dhe të reja, ideologjitë dhe perceptimet e asaj që bota duhet të jetë dhe konceptet e asaj që është njerëzimi, janë duke u përplasur për pushtet; dhe të gjitha llojet e orvatjeve janë duke u zhvilluar për ta kolonizuar atë."¹

Askush s'mund ta mohojë ndikimin që kanë gjitha këto në mendjen e muslimanit. Por a janë vërtet muslimanët aq pa drejtim siç mendojnë disa? Nëse i referohemi historisë së pejgambereve dhe vetë jetës së Muhamedit (a.s.), ne muslimanët në parim kemi një mision udhëzues. Ne nuk jemi këtu vetëm për të fituar pushtet, ose për të garuar me të, por si fillim të udhëzojmë pushtetet.

"Ai u largua prej tyre dhe tha: 'O populli im, unë ju solla shpalljet e Zotit tim e ju këshillova, prandaj pse të hidhërohem për popullin e pafë?!'" (Arafë, 93)

Allahu xh.sh. e ka vendosur vlerën e këtij umeti pikërisht në vazhdimësinë e udhëzimit të njerëzve. Muslimani nuk qëndron larg jetës, kohës dhe historisë, por ai bëhet pjesë e saj duke qenë faktor përmirësues i rrjedhave të kohës.

"Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit." (Ali Imran, 104)

Garancia e shpëtimit varet pikërisht nga përpjekja e njerëzve të cilët përmbushin këtë mision.

"E Zoti yt nuk është që të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë punëmirë." (Hud, 117)

Në shprehjen e më sipërme të Muhammed Ikbalit, por edhe duke iu referuar dijetarit turk Fethullah Gylen, është pikërisht braktisja e këtij misioni ajo që na ka poshtëruar kaq shumë. Me sa duket gjithë dyshimet tona, kontradiktat tona erdhën si rezultat i aktiviteteve tona, pa menduar aq thellë për natyrën e tyre thelbësore dhe rolin tonë të vërtetë. Fetuhullah Gylen do shkruante se:

"Allahu mund ta shkatërrojë një individ, shoqëri apo

popull, ose mund t'i zhdukë nën dhë, ndonëse ata e përmendin Allahun, e adhurojnë Atë dhe lexojnë lutjet përgjatë natës e ditës dhe ndonëse e vizitojnë Shtëpinë e shenjtë (Qabenë) dhe bëjnë tavaf rreth saj, por përderisa individ, shoqëria apo populli janë të preokupuar me kryerjen e misionit të tyre të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja dhe brengosen për të, atëherë Allahu e garanton atë vend, dhe i mbron banorët e tij nga shkatërrimi."²

Andaj edhe do ishte një kusht i domosdoshëm për ta parë veten nga ky kënd, dhe si një rast për të analizuar edhe gjendjen e çështjeve të tjera.³ Kur'ani e prezanton njeriun fillimisht si mëkëmbës të Zotit në Tokë, khalifeh. Njeriut i janë dhënë shumë mirësi si amanete nga Zoti, që ai të kujdeset për natyrën e jetës dhe t'ua ruajë gjërave identitetin e tyre, dhe kështu, si njeriu edhe vetë bota do e përmbushin misionin e tyre si krijesa të Zotit. Por, siç e thamë më lart, kjo e vërtetë është harruar kohë pas kohe dhe njeriu është sjellë si ka dashur me mirësitë dhe dhuntitë që i janë besuar. Por muslimani e di se sjellja dhe përfitimi e tij nuk mbarojnë në këtë botë, por përfundimi i veprave të tij ka edhe një ndikim në një tjetër nivel në të cilin do shkojnë njerëzit, akhireh. Duke qenë kjo e vërtetë që Kur'ani na e prezanton si "shpërblim për çdo vepër të mirë apo të keqe", atëherë brenga parësore e jona duhet të jetë udhëzimi, drejtësia, dhe jo fitimi i menjëhershëm i pushtetit. Fethullah Gylen ka shumë të drejtë kur shkruan se epiqendër e veprimeve të një besimtari janë imani dhe thirrja. Sekretet e ekzistimit të besimtarit dhe kushti i mbijetesës së tij si besimtar i vërtetë, është që ky ta përfaqësojë të vërtetën gjatë tërë jetës së tij.⁴

Krejt në fund duhet të kemi parasysh se "urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja" nuk janë thjeshtë si veprim me fjalë. Në hadithin e njohur të Pejgamberit (a.s.), ka treguar se ky mision kryhet me dorë, gjuhë dhe zemër. E gjithë infrastruktura që kanë ndërtuar muslimanët në të kaluarën, por edhe e gjithë puna e sotme duhet të ketë në parim përmbushjen e këtij misioni. Ndërtimi i shtetit eviton disa të këqija, me anë të cilave s'mundet askush tjetër. Shkollat evitojnë disa të këqija dhe mësojnë disa gjëra të mira. Universitetet, institutet, bibliotekat, xhamitë, bankat e laboratorët, secila nga këto eviton disa të këqija, dhe na ndihmon t'i përhapim disa gjërat e mira. Prandaj, ky është një mision që na pret të gjithëve. Secili ka mundësi të largojë një të keqe, secili ka mundësi të realizojë një të mirë. Jetojmë në mbretërinë e Zotit, dhe Atij i shërbejmë ashtu siç mundemi.

2. Fethullah Gylen, Rrugët e udhëzimit në ide dhe jetë, Dituria Islame, Prishtinë, 2012, fq. 41.

3. Po aty, fq. 21.

4. Po aty, fq. 32.

1. Ziauddin Sardar, Jordi Serra and Scott Jordan, Muslim Societies in Postnormal Times/Foresight for Trends, Emerging Issues and Scenarios, IIIT&CPPFS, UK, 2019, fq. XVIII.

Ramazani

MUAJI I KURANIT

Muaji i Ramazanit në vetvete është muaji i Kur'anit. Shkaku që e bën këtë muaj të bekuar, është zbritja e Kur'anit në të. Këtë fakt e shpreh dhe ky ajet: "Muaji i Ramazanit në të cilin u zbrit Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër)" (Bekare, 185). Në natën e shtatëmbëdhjetë të Ramazanit me anë të Xhibril Emin, Profeti të nderuar i zbritën ajetet e para të sures Alak: "Lexo në emër të Zotit që krijoi".

Kurani, burimi i orientimit dhe i rrugës së drejtë për besimtarët, është një libër që gjithmonë duhet lexuar, duhet menduar dhe medituar mbi të. Besimtarët myslimanë kanë nevojë për Kuranin sa ç'kanë për ajrin, ujin dhe bukën. Profeti ynë a.s. e ka kaluar gjithë jetën e vet, duke ua tërhequr njerëzve vështrimin dhe vëmendjen mbi Kuranin. E ka kënduar dhe përsëritur vetë, herë-herë i ka vënë edhe sahatet, shokët e tij ta këndojnë dhe i ka dëgjuar.

Enes b. Malik përcjell: "Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) lexonte shumë Kuran... gjatë Ramazanit ai priste lidhjet me çdo gjë tjetër dhe lexonte vetëm Kuran". Çdo natë të Ramazanit, Profeti bashkë me Xhibrillin mësonin së bashku Kuran. Në atë vit që do të ndërronte jetë Profeti, kjo mukabele pati ndodhur dy herë. Ibni Abasi përcjell:

"I Dërguari i Allahut ishte më bujari i njerëzve. Kurse koha kur bujaria e tij arrinte kulmin, ishte koha kur takohej me Xhibrillin në Ramazan. Gjatë çdo nate të Ramazanit, ai takohej me të dhe e këndonin Kuranin së bashku. Në

të mirë (bimirësi), Profeti ishte më i fuqishëm se era që fryn me vrell (Buhari, Saum, 7, Menakib, 23; Muslim, Fedail, 48, 50)".

Të lexosh Kuran është si të flasësh me Allahun xh.sh. Në këtë botë, nëse do na lavdëronte ose të na fliste, ose më e pakta të na hidhte sytë një njeri i madh me pozitë apo me famë, për ne kjo do të ishte një nder i madh. Madje, shumë nga ne këtë gjë do ua tregonim të afërmve dhe shokëve të tyre. Por harrojmë faktin që, kur lexojmë Kuran, ne komunikojmë drejtpërdrejt me Allahun e Madhëruar. Sa gjë me vlerë dhe e bukur. Sa vlerë që na ka dhënë Zoti kur pranon të flasë me ne. Madje kjo nxitet nga Ai Vetë. Një begati e madhe ndër begatitë e xhenetit, është biseda që Allahu i Madhëruar bën me ne: "Selamun Alejkum, qofshi të shpëtuar, ishit të pastër, prandaj hyni në të, aty jeni përgjithmonë" (Zumer, 73). Ndërkohë që ne kemi mundësi që në një formë ta përjetojmë këtë gjë duke lexuar Kuran.

Kurani është si një litar i zbritur nga qielli. Cili komb e ka kapur këtë litar, ka ecur përpara. Në një hadith Profeti thotë: "Ky Kuran është një lidhje ku, njëra anë është në duart e Allahut dhe tjetra në duart tuaja. Kapuni fort tek ajo që të mos devijoni asnjëherë nga rruga e drejtë dhe të mos shkatërroheni" (Sahih Ibn Hibban, 1, 166).

Kurani është vendosur mbi shpatullat tona si një begati hyjnore. Duke e pranuar si detyrë të shenjtë, duhet ta ngremë sa më lart flamurin e tij. Këtë do e arrijmë duke e lexuar më shumë dhe duke e kuptuar dhe jetuar atë.



Jurisprudencia e agjëërimit



Kush duhet të agjërojë

Ashtu si te adhurimet e tjera, edhe te agjërimi, janë bërë përgjegjës për të agjëruar personat që kanë zotëruar kriterat e kërkuara tek ta. Këto mund t'i radhisim:

1) Personi duhet të jetë mysliman. Që dikush ta ketë detyrim (farz) agjërimin, duhet ta ketë pranuar Islamin, domethënë duhet të jetë mysliman. Personat që nuk janë myslimanë nuk mund të detyrohen të agjërojnë.

2) Personi duhet të ketë mbushur moshën e pubertetit dhe të ketë zhvillim mendor normal. Që dikush të jetë i detyruar për të kryer adhurimet që përmban Islami, duhet të plotësojë edhe këto dy kushte si më sipër: Të ketë arritur moshën e pubertetit dhe në të njëjtën kohë, të ketë zhvillim mendor normal. Në Islam, personat që nuk e kanë mbushur ende moshën e pubertetit, nuk konsiderohen fetarisht përgjegjës për të kryer adhurime të caktuara. Konkretisht, fëmijët dhe personat me të meta mendore janë përjashtuar nga detyrimi i agjërit. Këtë specifikë i dërguari i Allahut (s.a.s.) e ka bërë të ditur me këto fjalë: "Përgjegjësia është hequr nga tre vetë: Nga fëmija që s'ka arritur ende moshën e pjekurisë seksuale (adoleshencës), nga i sëmuri mendor gjersa të shërohet dhe nga personi që fle gjersa të zgjohet!" (Buhari, Hudud, 22; Ebu Davud, Hudud, 17; Tirmidhi, Hudud, 1; Ibni Maxhe, Talak, 15; Ahmed b. Hanbel, Musned, 6/100, 101, 144).

3) Personi duhet të jetë i shëndetshëm për të agjëruar dhe duhet të jetë vendas. Që dikush ta ketë për detyrë (farz) agjërimin, duhet të jetë fizikisht i shëndoshë (të mos ketë të meta trupore që e bëjnë të paaftë për të agjëruar), duhet të jetë klinikisht i shëndoshë, pra të mos jetë i sëmurë dhe të jetë vendas, pra jo në udhëtim. Ndërkaq, po që se këta persona, megjithëkëtë agjërojnë, agjërimi i tyre është i vlefshëm. Por po që se e përdorin lejen që u është dhënë dhe nuk agjërojnë, ditët e paagjëruara i zëvendësojnë në një kohë më pas.

Kush nuk agjëron

1. Udhëtarë. Në një situatë të tillë, për shkak të vështirësive të udhëtimit, njeriu mund ta ketë të vështirë për të mbajtur agjërim. Për këtë arsye Kur'ani, myslimanët në gjendje udhëtimi i ka lejuar të mos agjërojnë. Ai që nuk ka mundur të agjërojë duke qenë në udhëtim, ditët e paagjëruara i agjëron si kaza më pas. Por ata që dëshirojnë, mund të agjërojnë edhe kur ndodhen në udhëtim.

2. Sëmundja. Krijuesi i Lartë u ka dhënë leje edhe personave të sëmurë që nuk mund të agjërojnë, i ka përjashtuar ata nga përgjegjësia e agjërit. Këta, pasi të shërohen, agjërimet e pambajtura i mbajnë kaza. Kurse të sëmurët me sëmundje të rënda, me ecuri të gjatë ose të pashërueshme, të cilët nuk mund të agjërojnë, duhet të japin shpërblim (fidje). Kur'ani urdhëron e thotë:

"Agjërimi përbëhet prej ditësh të caktuara (të numëruara). Kush nga ju është i sëmurë ose udhëtar gjatë atyre ditëve, ditët e paagjëruara i agjëron më pas. Ata që nuk agjërojnë dot, duhet të paguajnë shpërblim (fidje). Fidja është masa (monetare ose ushqimore) sa për të ushqyer një të varfër. Kush e rrit masën e fidjes për të bërë mirësi, sigurisht e ka për dobi të vet. Megjithëkëtë,

po ta dini të vërtetën, mbajtja e agjërit është më e mbarë për ju!" (Bekare, 184)

3. Pleqëria. Islami u ka dhënë leje për të mos agjëruar personave me pleqëri të rënduar, që nuk mund të agjërojnë me kusht që për çdo ditë të paagjëruar të ushqejnë një të varfër.

4. Gratë me arsye. Gratë me të përmuajshmet, lehona, shtatzëna ose në periudhën e laktacionit (me fëmijë në gjil), me qëllim që të mos dëmtohen vetë si dhe fëmijët e tyre, përfitojnë nga leja për të mos agjëruar. Ato i agjërojnë më vonë kaza ditët e paagjëruara (Ibni Maxhe, Sijam, 3; Nesai, Sijam, 50-51, 62).

5. Uria dhe etja e thellë. Po që se personi që agjëron përballet me një etje ose uri të rëndë dhe po që se frikësohet se mos agjërimi do t'i prekë në përmasa serioze shëndetin trupor dhe psikik, ose po që se mjeku i jep raport për të mos agjëruar, ky person përjashtohet nga detyrimi i agjërit në këto kushte dhe, pasi të fitojë shëndet të plotë, e plotëson këtë adhurim duke i zëvendësuar ditët e paagjëruara.

Çfarë e prish agjërimin

Në këndvështrim të përgjithshëm agjërimin e prishin:

• Marrëdhëniet seksuale mes burrit dhe gruas nga agimi deri në perëndimin e diellit.

- Ngënia, pirja apo përdorimi i ilaçeve
- Pirja e duhanit, thithja e thellë e tymrave, avujve etj.
- Përtypja e çamçakëzit
- Hyrja në trup e diçkaje nga goja, hunda, veshi etj.
- Dalja e gjakut nga goja dhe gëlltitja e tij, etj.

Abdullahu, djali i Abazit, ka treguar se profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "Prishja e agjërit vjen nga ato sende që hyjnë në trup e jo nga ato që dalin prej tij" (Buhari, Tirmidhi).

Si për çdo adhurim, edhe për agjërimin e muajit të Ramazanit që mbahet një herë në vit, ka një sërë rregullash që duhen respektuar. Këto rregulla kanë të bëjnë me tri lloje situatash në të cilat gjendet personi që agjëron:

1) Situatat që e prishin agjërimin, por kërkojnë vetëm (kazanë), zëvendësimin e tij. Këto situata ndodhin kur agjëruesi padashje me shkujdesjen e tij, ose duke gabuar pa qëllim, e prish agjërimin. Në këto lloj rastesh, personi vetëm atë ditë e kompenson pas muajit të Ramazanit.

2) Situatat që e prishin agjërimin dhe kërkojnë edhe kazanë, edhe (kefare) kundërshtpërblimin e tij. Kjo ndodh kur agjëruesi e prish agjërimin pa arsyet e caktuara, me qëllim dhe vetëdije të plotë. Ai që e prish me dashje agjërimin e Ramazanit, duhet të agjërojë ditën ose ditët që ka prishur, si dhe gjashtëdhjetë ditë radhazi pa ndërprerje si ndëshkim. Në pamundësi për këtë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër.

3) Situatat që nuk e prishin agjërimin kur ndodhin në harresë. Kur agjëruesi në harresë e sipër e prish agjërimin, prej tij nuk kërkohet gjë tjetër veç të vazhdojë agjërimin. Një herë erdhi një sahabë te Profeti (a.s.) dhe i tha: O i dërguari i Zotit! Kam harruar se jam me agjërim dhe kam ngrënë e kam pirë. Profeti (a.s.) i tha: "Vazhdo në agjërimin tënd, Zoti (xh.sh.) ta ka dhuruar atë ngrënie e pirje" (Buhari).

NDIKIMI I AGJËRIMIT NË PROCESET BIOKIMIKE DHE BIORITËM

Allahu i madhërishëm në Kuranin fisnik urdhëron e thotë:
"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.

(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjëjnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.

(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në te (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmure ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni." (El - Bekare, 183-185)

Agjërimi është institucion i edukimit shpirtëror dhe muaji Ramazan është periudha e lulëzimit të vlerave shpirtërore dhe humane.

Agjërimi na ofron mundësinë që t'i akordojmë natyrës dhe karakterit tonë dhe njëkohësisht të zhvillohen tek ai cilësitë e durimit, ekuilibrit, kontrollit dhe vetëpërmbytjes.

Agjërimi është i karakterizuar me vlera unikale, morale, shpirtërore dhe edukative.

Është pikërisht ky sistem i vlerave i kristalizuar në këtë ritual adhurimi, i cili simbolizon urtësinë hyjnore të Krijuesit të Gjithëdijshëm.

Duke vlerësuar planin teologjik, rituali i agjërimit konsiston në: ndërtimin e sistemit të vlerave, në edukimin

moral e shpirtëror dhe në formimin e karakterit devocional të jetës njerëzore.

Arritja e devotshmërisë është vendimtare për të cilën synon çdo besimtar i mirëfilltë. Ajo e aftëson njeriun t'i nënshtrohet urdhrave hyjnore.

Pos kësaj agjërimi vendos një ekuilibër mahnitës mes trupit dhe shpirtit që ata të përjetojnë së bashku një ekzistencë të harmonizuar paqësore.

Muhammedi, s.a.v.s., ka thënë: "Agjëroni, do të jeni i shëndetshëm."

Ja, kjo thënie e tij para 14 shekujsh, sot po vërtetohet nga shumë eksperimente të bëra në qendra mjekësore botërore. Është i madh numri i mjekëve me renome botërore të cilët vërtetojnë efektet mahnitëse të agjërimin në organizmin e njeriut. Do të citojmë vetëm disa prej tyre:

Dr. Alexis Carrel (fitues i çmimit Nobel në mjekësi - 1940), në librin e tij "L'homme cet incanu" - (Njeriu, ky i panjohur) thotë: "Gjatë agjërimit shpenzohen dhjamërat dhe lëndët e tepërta të depozituara në trup, e më pas këto zëvendësohen me të reja, kështu ndodh një ripërtëritje në trup."

Agjërimi, shërim për shumë sëmundje, e kanë vërtetuar mjekët me renome botërore si: Dr. Dexeux, Dr. Guelp, Dr. Frumusan, Dr. Noman, Dr. Pauchet.

Pas studimit të gjatë, Dr. Noman ka vërtetuar se agjërimi gjatë Ramazanit shkakton një ngritje të shënuar të kolesterolit me densitet të lartë (HDL) dhe zvogëlon kolesterolin me densitet të vogël (LDL).

Studimi është përcjellur në 32 meshkuj të shëndetshëm. Zvogëlimi sinjifikant (7,9%, $p < 0,001$) në serum të koncentrimin të kolesterolit total dhe triglicerideve (30%, $p < 0,001$) gjatë muajit Ramazan është krahasuar me periudhën para agjërimin. Pas përfundimit të Ramazanit, serumit HDL kolesterolit është ngritur dukshëm (14,3%, p

< 0,001) dhe ka mbetur i ngritur niveli edhe një muaj pas Ramazanit në krahasim me LDL kolesterolin që ka treguar zvogëlim sinjifikant (11,7%, $p < 0,001$).

R. Habbal dhe autorët nga Qendra kardiologjike e Spitalit Universitar Ibn Roch në Kasablankë (Marok), në studimin e përfshirë 72 femra dhe 27 meshkuj me hipertension (shtypja e lartë e gjakut) vërtetuan ulje sinjifikante të tensionit të gjakut gjatë muajit Ramazan. Kjo për arsye të natriurezës.

Agjërimi nxit efektin natriuretik, që e lejon trupin të eliminojë natriumin dhe ujin e tepërt nga organizmi. Kjo lejon zgjidhjen e problemeve kronike me të enjtura (edemë), ndihmon në uljen e volumit të rritur të gjakut, bashkë me uljen e tensionit të lartë të gjakut.

Agjërimi i Ramazanit mund të shërbejë si model i shkëlqyer për hulumtime të metabolizmit të njeriut dhe sjelljes së të ushqyerit. Gjatë 20 viteve të fundit janë bërë përpjekje të shumë shkencëtarëve dhe agjërimi i Ramazanit është përdorur si model për shumë studime metabolike (Iraki et al, Ayabak et al, Husain et al, Malik et al, El Ati et al, Nomani et al, Sweileh et al dhe Malhotra et al, etj.).

Shkencëtarët gjatë hulumtimit vërtetuan se gjatë agjëritimit niveli i magneziumit në gjak rritet.

Magneziumi ka efekt mbrojtës kardiovaskular dhe shërben për prevenimin dhe shërimin e sulmeve në zemër.

- Ai përmban në vete cilësi antitrombocitare dhe mbron nga përhapja e trombeve.

- Ka efektin stabilizues i membranës qelizore që vepron në marrëdhënien e kaliumit dhe kalciumit në nivelin membranor. Për këtë ai mbron nga disritmitë e zemrës dhe trurit.

- Agjërimi nëpërmes efekteve të magneziumit parapengon formimin e ateromeve (plakëzat e yndyrës të cilat krijohen në enët e gjakut) dhe zbërthen këto plakëza të cilat janë përgjegjëse për sulme në zemër dhe tru.

- Magneziumi rrit aktivitetin fibrinolitik të gjakut i cili udhëheq kah prevenimi dhe krijimi i koagulëve të rinj.

Gjatë agjëritimit tajimi i hormoneve të gjëndrës hipofizare rritet, sepse ekziston hormoni anabolik për sintezën e proteinëve dhe kolagenit i cili prodhon baraspeshën pozitive të azotit. Ai gjithashtu stimulon eritropoezën dhe sintezën e kolagenit.

Gjatë agjëritimit, namazit dhe përvojave të ndryshme shpirtërore në Ramazan, disa substanca të caktuara endogjene nëpërmes trurit lirohen në organizëm.

Këto substanca quhen opoide. Këto përfshijnë enkefalinën dhe endorfinën që janë përgjegjëse për eufori, qetësi, disponim dhe çiltërsi gjatë kësaj periudhe.

Beta-endorfinët janë më aktivët. Këta janë 20 herë më të fuqishëm se morfina.

Këta përveç që eliminojnë dhembjen, shkaktojnë ndjenjën e fortë të euforisë.

Gjatë agjëritimit arrihet rikalibrimi enzimatik. Organizmi shton ndryshimet enzimatike që ndikojnë në rregullimin e shumë sistemeve si detoksifikimi nga substancat helmuese, shpenzimi i rezervave dhjamore dhe rezervimin e proteinave. Ky është edhe shkaku i përmirësimit të gjendjeve klinike të pacientëve.

Atmosfera shpirtërore gjatë agjëritimit ul stresin. Stresi

ndikon në kualitetin e jetës dhe është shkak potencial për shumë sëmundje.

Agjërimi lehtëson dhe mobilizon eliminimin e substancave të dëmshme nga organizmi si: kolesteroli, acidi urik, dioksina dhe mbetje të tjera toksike.

Agjërimi ka një ndikim normalizues në sistemin autonom nervor. Ul shqetësimet në sistemin digjestiv si dhe qetëson gjendjen e ankthit.

Agjërimi përbën një periudhë pushimi për organet e sistemit tretës dhe zemrës:

- Mëlçia (laboratori qëndror i organizmit) pushon 4-6 orë.

- Zemra gjatë ditës rrah 14.000 herë më pak.

- Veshkët gjatë agjëritimit pushojnë dhe ripërtërihen.

- Zorrët kanë një periudhë pushimi dhe ullet ritmi i punës së tyre.

Agjërimi ka efekt stabilizues edhe te diabetikët, sepse ngrit nivelin e insulinës.

Poashtu efekt evident, agjërimi ka treguar te sëmundja e Alzheimerit (demencë e hershme e trurit), padyshim si pasojë e efektit detoksifikues të agjëritimit në sistemin nervor.

Agjërimi është sekret i jetëgjatësisë.

Poashtu ka efekt antikancerogjen.

Agjërimi ndihmon në lehtësimin e sëmundjeve si artriti, koliti, astma, alergjitë e ndryshme dhe largon lodhjen.

Kokëdhembja që paraqitet në ditët e para të Ramazanit veçanërisht te konsumuesit e kafesë dhe duhanit, gjithashtu shoqërohet me humbje të gjumit dhe me ndjenjën e urisë. Këtyre personave u këshillohet që të fillojnë t'i lënë kafënë dhe duhanin dalëngadalë qysh para një ose dy javë para Ramazanit.

Vendin e kafesë duhet ta zënë pijet pa kafeinë, si bli, çaj mali dhe pije joalkoolike.

Niveli i ulët i sheqerit në gjak (hipoglikemi) shoqërohet me dobësi, marramendje, lodhje, dobësi në përqendrim, djerësitje e shpejtë, dridhje (tremor), paaftësi për veprimtari fizike, kokëdhimbje, rrahje zemre e fortë.

Si shkak është marrja e bollshme e sheqerit veçanërisht në syfyr në formën e karbohidrateve të rafinuara. Si përgjigje, trupi sekreton shumë insulinë, gjë që shkakton rënien e nivelit të sheqerit në gjak.

Këtyre personave u këshillohet që në syfyr të marrin pak dhe në mënyrë të kufizuar ushqime me sheqer, të pijnë lëngje.

Të agjërosh prej të ngrënit, të pirit, dëshirave tunduese, shikimeve provokuese, prej të folurit përgojues, shpifjeve, ofendimeve, sharjeve, prej të menduarit djallëzor, ndaj intrigave, kompleteve e parapaskenave, është pikërisht ky ridimensioni i vlerave të karakterit njerëzor.

Thesari shpirtëror si gjëja më e çmuar, është pikërisht ndërtimi i këtij sistemi vlerash në personalitetin dhe karakterin tonë, me qëllim që jetën, shëndetin, dhe energjinë shpirtërore, që na ka dhuruar Allahu i madhërishtëm, ta përjetojmë në formë të dobishme për veten, familjen dhe shoqërinë.

Na e pranofte Allahu agjërimin tonë, ibadetet dhe veprat tona dhe na bashkoftë nën bajrakun e Kuranit në Ditën e Gjykitimit.

Lutja jonë e fundit të jetë:

Lavdia i qoftë Allahu, Sunduesit të botëve!



HAFIZ SHERIF LANGU
(1877-1956)

Sherif Langu lindi në qytetin e Dibrës së Madhe më 1877. Mësimet e para i mori në medresenë e këtij qyteti. Më 1894 djaloshi 17 vjeçar ishte në lidhje të ngushta me atdhetarët Said Najdeni, Kadri Fishta dhe Shaqir Daci. Mes tyre, me kurajë e guxim iu përvesh punës për propagandimin e shkollës shqipe. Petku fetar dhe detyra e imamit, që kryente në një lagje të qytetit, nuk e penguan në aksionin e shpërndarjes së abetareve.

Duke jetuar zhvillimet që kalonte Dibra në fund të shek. XIX, Sherifi së bashku me patriotë të tjerë është i pranishëm në tërë ngjarjet. Ai merr pjesë në Kuvendin e madh të Dibrës të 27 shkurtit 1899. Prindërit, veçanërisht gjyshi Selim Bej Rusi, duke parë tek ai një të ri inteligjent, të zgjuar e me të ardhme, e ndihmuan që të vazhdonte studimet në Manastir e më pas për teologji në Stamboll. Këtu pati mundësi t'i zgjeronte njohuritë fetare e shkencore duke u njohur njëkohësisht me atdhetarë dhe rilindës të shquar. Mes rilindësve si Ibrahim Temo, Dervish Hima e të tjerë, Sherifi u afirmua më tej me idealin kombëtar dhe përkushtimin për t'i shërbyer Atdheut. Ai gjatë vitit 1907 lëviz me mision sa në Dibër e sa në Manastir. I njohur me aktivistë të klubit të Manastirit, bën një punë të madhe duke formuar në dhjetor 1908 klubin "Bashkimi" të Dibrës. Si kryetar i këshillit administrativ të këtij klubi, së bashku me aktivistë të tjerë si: Kadri Fishta, Riza Rusi, Eqerem Cami, Ibrahim Xhidri, Abdullah Tërshana dhe Ibrahim Jegeni, zhvillon një aktivitet të dendur në dobi të çështjes kombëtare. Krahas përpjekjeve të vazhdueshme për shkollë shqipe, së bashku me aktivistë të tjerë luan një rol të rëndësishëm në organizimin e Kongresit të Dibrës të 23 korrikut 1909. Në fund të qershorit 1910, Turgut Pasha, pasi kishte shtypur qëndresën në qytetin e Dibrës, u fut në zyrat e klubit "Bashkimi" dhe sekuestroi tërë dokumentet e klubit.

Pas kësaj, bashkë me patriotë të tjerë dibranë, bëhet inspiruesi i disa mitingjeve e peticioneve me anë të të cilave këmbëngulej në dhënien e lejes për shkollë shqipe. Dibranët, duke parë te Hafiz Sherifi një atdhetar të flaktë, me dhënien e lejes për shkollë shqipe, e zgjedhën unanimisht mësues. Hafiz Sherif Langu e shikonte nga afër fundin e perandorisë, ndaj iu vu punës për organizimin e kryengritjes. Në fund të qershorit të vitit 1912, së bashku me Eqerem Camin, Ismail Strazimirin, Tajar Tetovën, Ramadan Camin, Sulejman Shehun e Zerkanit e të tjerë, merr pjesë në kryengritje. Kjo kryengritje çoi në çlirimin e Dibrës.

Ai tani, me personalitetin e tij fetar, patriotik

dhe si luftëtar e udhëheqës popullor ishte bërë figura më e dashur në mbarë Dibrën. Është kjo arsyeja që së bashku me Haxhi Vehbi Agollin (Dibrën) u zgjedhën përfaqësues të saj për në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Me okupimin serb të viseve të Dibrës dhe Elbasanit nisët nga Vlora me mision në këto anë për të organizuar qëndresë. Autoritetet serbe e arrestojnë, por përballë presionit të popullit, pas disa kohësh detyrohen ta lirojnë përsëri.

Në Elbasan u fut në lidhje me Aqif Pashë Elbasanin, me të cilin pati një bashkëpunim të vazhdueshëm në dobi të çështjes kombëtare. Duke ruajtur lidhjet me Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, iu përvesh punës për të lidhur fiset e Dibrës me administratën e Vlorës. Me ndihmën e Aqif Pashës, në krye të një komisioni të përbërë nga Tajar Tetova, Haki Ismail Peqini, Ahmet Dakli nga Elbasani, ndërmerr disa herë misione në viset e Dibrës, duke kontribuar në ngritjen e pushtetit lokal. Në këtë mision ai bashkëpunoi me Ramadan Camin, Hoxhë Muglicën, Hoxhë Kurt Ballën e shumë atdhetarë të tjerë. Nga fundi i vitit 1913 deri më 1917 kryen detyrën e kadiut (gjyqtarit) në viset e Dibrës që mbetën me Shqipërinë. Malli për vendlindjen e hodhi në qytetin e Dibrës ku nga viti 1920 gjer në vitin 1938 kreu detyrën e imamit dhe në disa raste të kadiut. Këtu pati mundësi të vihet në lidhje me miq e shokë të vjetër. Tashmë eminenca e tij përbënte rrezik për shtetin jugosllav, i cili e mbante atë nën vërejtje. Nga viti 1938 gjer në prill të vitit 1941 kryen detyrën e kryetarit të këshillit të ulemave në Shkup. Këtu, duke parë se veprimtaria e tij e mëtejshme ishte në rrezik, largohet për në Tiranë ku u ngarkua me detyrën e kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Nga ky post i lartë predikoi prosperitet e tolerancë mes besimeve fetare, dashuri, bashkim vëllazëror fetar e kombëtar. Si patriot i vendosur aspiroi e punoi për Shqipërinë etnike.

Pas çlirimit, ndonëse në moshën 70-vjeçare, nën akuzën për agjitacion e propagandë dënohet me dhjetë vjet burgim. Qëndrimi i tij në burg dëshmon për karakterin e fuqishëm. Lirohet në vitin 1950 dhe vdes më 9 mars 1956, duke u lënë brezave mesazhin e besimit e atdhedashurisë.¹

Më poshtë po japim një telegram dërguar Kryqit të Kuq Ndërkombëtar ku, nën petkun zyrtar të kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar, shpreh dhimbjen e thellë për krimet e luftës në të gjitha trevat shqiptare nga pushtues të ndryshëm, qofshin ata fqinjë, apo aleatë.

1. Lidhja e historianëve shqiptarë dibranë, "Dibra dhe etnokultura e saj", vëllimi i dytë, Dibër, 1995.

Telegrami i dërguem nga Kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar Kryqit Kuq Ndërkombëtar rreth bombardimit të Pejës

Zotnisë së Tij,

Presidentit Kryqit Kuq Ndërkombëtar BERNË

Ngjarjet e luftës së tashme dhe pasojat e saj tragjike mbi popullin Shqiptar, më kanë shtyrë t'i drejtohem, me cilësinë t'eme si Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipnis, Institutit të lartë humanitar të kryesuem prej Zotnisë s'Uaj, me lutje që të keni mirësinë t'ua njoftoni përmbajtjen e këtij telegrami autoriteteve kompetente aleate, Qendrave të Gjysmë-Hënës së Kuqe Turke, Egjyptase, Persiane, Irakjane dhe Indiane si dhe Komitetit Panarab.

Dy ngjarje tragjike e kanë goditur në kohët e fundit vendin t'em:

1) Bombardimi tragjik i Pejës shkaktoi më 13 gusht

'944 një numër të madh viktimash, të cilat, simbas vërtetimeve më të fundit, arrijnë trimijë të vrarë dhe disa mijëra të plagosur, midis popullsis muslimane shqiptare, e cila ka qenë ajo vetëm e goditur, mbasi ajrorët aleatë kanë synuarë vetëm lagjet Muslimane.

2) Masakra janë kryem në Çamëri prej çetave të armatosura Greke të Zervës të cilat e kanë grirë në kohët e fundit popullsin civile shqiptare të Paramithis dhe të krahinave fqinje. Disa qindra Shqiptarë muslimanë, ndër të cilët Myftiu i Paramithis dhe shumë nga parijs, janë masakruar pa mëshirë në këtë rast. Shumë katunde e xhamia janë plaçkitur e djegur dhe popullsia civile, e tmeruar nga rreziku i çetave të armatosura të Zervës, ka lënë krejt vendin. Afro njëzetmijë refugjatë kanë kaluar kështu lumin Kalama dhe kanë ardhur përkëndeje për të kërkuar mbrojtje duke vuajtur tash nga mungesa e ushqimeve e të tjerave sende të nevojës së parë.



Nxitoj t'Ju shpreh me këtë rast falënderimet dhe ndjenjat e mirënjohjes së Komunitetit Mysliman të Shqipnis dhe të mijat personale për ndihmat e para që Kryqi Kuq Ndërkombëtar pati mirësinë t'i japë kësaj popullsije fatkeqe.

....Edhe gjatë kësaj lufte lista e vuajtjeve të hidhta përmban shumë viktima, që kanë rënë ndër ngjarje tragjike. Nga më të dallueshmit, përmendim masakrimin e afro 5.000 muslimanëve i ndodhun në muejin Jenar 1943 në krahinën e Bihorit midis Malit të Zi dhe Shqipnis dhe i shkaktuar prej sulmeve agresive të çetave çetnike serbo-malazeze. Herë mbas here sulme të reja ndodhin kundër krahinave Shqiptare të Kosovës -Metohis- qoft nga ajri prej ajrorëve aleatë, qoftë nga toka prej çetave serbo-malazeze të ç'do tendence.

Do t'ish mirë që zhvillimet e rënda të luftës të mos shtrihen mbi një popullsi të pambrojtun dhe mbi qytete që nuk përbëjnë asnjë objektif ushtarak dhe kemi arsye

të besojmë se aktet terroriste ajrore kundër popullsis s'onë myslimane janë kryer vetëm mbi shtytjen e fqinjëve t'anë armiq shekullorë të racës t'onë, të cilët nuk kërkojnë tjetër veçse çfarosjen e saj.

Po i drejtohem ndjenjave njerëzore të Kombeve të Bashkueme dhe opinionit të tyre me qëllim që të bëjnë pranë Komandave të tyre përkatëse ndërhyrjet e nevojshme me qëllim që akte terroriste të këtij lloji të mos përdoren kundër popullit Shqiptar kaq shumë të goditur gjer më tash nga kjo luftë botore.²

Kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar H. SHERIF LANGU³

2. Origjinali është dërguar në frëngjisht dhe është botuar tre numra më pas në revistën "Kultura Islame", gusht 1944, nr. 12: 347-348.

3. Për më tepër shih, gazeta "Drita Islame", nr. 9 (34), korrik 1993: 3.





TRASHËGIMIA E MADHE E Muhamet Çamit (Kyçykut)

Në qarqet e gjera të intelektualëve-atdhetarë çamë të zonës së Konispolit, shkëlqen figura e Muhamet Çamit, ose siç njihet në disa mjedise, Muhamet Hamza Kyçykut, përfaqësuesit më të shquar të letërsisë çame të shekujve XVIII-XIX, mësuesit dhe drejtuesit të Medresesë së Konispolit, poliglotit të gjuhëve të Lindjes, studentit të shkëlqyer të Al-Az'har-it, njërit prej universiteteve më të pëlqyer të shqiptarëve të shekullit XIX.

Jeta e Muhamet Kyçykut si intelektual, është në

mënyrë të pareshtur impulsive. Kahet e saj janë në disa drejtime: ai bën jetën e një organizatori të shkëlqyer e pedagogu të zgjedhur në ngritjen në një nivel të ri të shkollës që drejton, bën jetën e një krijuesi artistik, i frymëzuar nga ndjenja fisnike, bën jetën e një idealisti dhe njëkohësisht atdhetari, duke e ngritur gjuhën amtare në gjuhë mësimi.

Të gjitha këto ai i bëri sepse deshi t'i rrisë lavdinë e vendlindjes së tij, Konispolit, duke e bërë shkollën që drejtonte një qendër kulture, që do të rrezatonte

qytetërim dhe kulturë islame, sepse deshi që nxënësit e tij të edukohen me frymën e së drejtës, të së bukurës, të së mirës. I frymëzuar nga mësimet e Profetit a.s., ai punoi, hartoi dhe shqipëroi më se njëzet vepra, sepse deshi që nxënësit të kuptojnë më shumë, të dinë më shumë, të gjykojnë më shumë, duke u mësuar në gjuhën e nënës, në gjuhën amtare shqipe. Ai u la pasardhësve jo vetëm trashëgiminë letrare, por edhe shembullin e tij si udhëheqës e edukator shkolle, qëndrimin e tij ndaj punës, emrin e tij plot lavdi dhe premtime e shpresa të mëdha për të ardhmen.

Historiografia jonë e arsimit nuk e ka rrokur këtë fakt të rëndësishëm, që në medresenë e Muhamet Çamit mësimet zhvilloheshin në gjuhën amtare, se tekstet e kësaj shkolle kishin autorësinë e Muhamet Çamit dhe se ato ishin shkruar në shqip, se kjo gjuhë tingëllonte më e kuptueshme, më e afërt, më e përzemërt se çdo gjuhë tjetër dhe nxënësit filluan t'i kopjojnë veprat e mësuesit të tyre, drejtorit të tyre, paçka se me alfabetin turko-arab.

Të kujtojmë se në ato vite që vdiq Muhamet Çami (1844), u botua "Ëvetari" shqip i Naum Veqilharxhit. Veprat e Muhamet Çamit, si "Erveheja", "Jusufi e Zyliahja", "Tahiri dhe Zyhraja", të shkruara në shqip qarkullonin dorë më dorë. Ato qenë bërë edhe ushqim për rilindësit, qysh kur Jani Vreto tentoi t'i përshtaste me kërkesat e reja të gjuhës së përpunuar. Në këtë aspekt, medreseja e drejtuar nga Muhamet Çami ishte më e mirë, më e dobishme dhe qëndronte më lart se medreseja dhe "Zosimea" e Janinës. Shumë nga nxënësit çamë të kësaj medreseje, si edhe ata të zonës së Fterrës, Tragjasit, Backës, Vëndreshës etj., propaganduan mësimin e gjuhës shqipe.

Edhe vetë fakti që kjo medrese e ngritur qysh më 1700-1720, mbijetoi deri më 1940, dëshmon se kishte formuar tiparet thelbësore të një institucioni arsimor të qëndrueshëm. Me gjithë kthesat që pati, edhe kur më 1917 ajo u shndërrua në dydegëshe (shkollë shqipe dhe medrese) dhe më 1924 u shndërrua e tëra në shkollë plotore shqipe, dëshmon se ajo kishte një traditë të pasur.

Vetiu lind pyetja: Cili, ose cilët intelektualë nga Konispoli kanë ndërmarrë një studim të gjerë për trashëgiminë kulturore, pedagogjike, artistike, organizative e atdhetare të këtij burri të madh? Cili, ose cilët nga ne jemi shtyrë për të pasqyruar dhe hedhur dritë mbi këtë shkollë shqiptare më se dyshekullore, ku kanë studiuar personalitete të shquar si Osman Rushiti, Rushit Dine Haliti etj.? Cili nga ne ka bërë një studim për veprat që kanë lënë nxënësit e kësaj shkolle? Për fondin e bibliotekës së saj? Për format e punës të përdorura nga kjo medrese?

Konispoli është një qendër e lashtë iliro-epiroto-shqiptare. Gjurmët e teatrove të vjetër shtyhen në shekullin IV dhe të III para erës së re. Arkeologët shqiptarë kanë rënë në gjurmët e vendbanimeve të hershme, siç janë Bregu i Sterrës, Çuka e Aitoit etj.. Çuka e Aitoit, që i përket Kaonisë së Epirit, gjendet mbi kodrën që zotëron fushën e Vrinës ose Kestrinën antike. Pa u ndalur në emrin e ri Konispol, që mori kjo

zonë, duhet thënë se në kohët më të reja, Konispoli dhe i tërë territori përreth mori zhvillim ekonomiko-kulturore dhe nxori shumë figura të shquara. Mjafton të përmendim Hasan Tahsinin nga Ninati e vite më pas "Klubin e shkrimit të gjuhës shqipe", të ngritur në qendër të Konispolit më 1910.

Historia e letërsisë shqiptare të Rilindjes sonë kombëtare nuk mund të kuptohet pa përfshirjen e veprës së Muhamet H. Kyçyikut.

Për të kanë shkruar Jani Vreto, specialisti i shkrimtarëve të alhamiadës, Osman Myderrizi, Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi, Dhimitër Shuteriqi, Ibrahim Hoxha, Muhamet Piraku dhe Muhamed Hysa. Unë, në vitin 1998, në monografinë "Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë", i kam kushtuar katër faqe veprës së Muhamet Kyçyikut. Por nga të gjithë nuk është bërë ndonjë studim i veçantë dhe analitik përmbi veprat e shkruara prej tij. Ai ka vepra me përmbajtje fetare, siç ka edhe Fishta, Noli e Kristoforidhi, por ka edhe punime të tjera me karakter social.

Veprat me subjekt fetar trajtojnë tema nga historia islame, nga mësimet e Kur'anit, nga sentencat e profetit Muhamed a.s., elegjinë kushtuar vdekjes së profetit Muhamed a.s. etj.. Ndër veprat e tjera, meriton të vihet në dukje edhe "Gurbetlinjtë", temë aktuale edhe sot. Emigrimi, kjo plagë e madhe shoqërore, që ka gërryer shoqërinë shqiptare vazhdimisht, gërryen edhe zemrën e poetit të Konispolit, gati 200 vjet më parë. Edhe poezia tjetër "Bekriu", është temë aktuale.

Këtu kemi spektrin etik të tij, natyrisht në aspektin e edukimit islam dhe edukatës islame.

Për të ilustruar forcën e shprehjes së tij, bukurinë e fjalës dhe të stilit, po sjell më poshtë një strofë nga vargjet e poezisë "Gurbetlinjtë":

"Ç'ke moj zemër që bën figan (loto)
që s'bën karar natë e ditë (nuk gjen qetësi)
po kullon gjak edhe katran,
qan që t'u këpunë sitë."

Por vepra më madhore e tij është poema "Jusufi e Zyliahja". Ajo ka natyrë tregimtare, gjuhë të pasur dhe stil të bukur, ka analiza psikologjike, vargje 8-rrokëshe të poezisë popullore trokaike, po edhe jambike dhe nota origjinaliteti. Dy protagonistët e kësaj novele të parë shqiptare përfaqësojnë dy tipa të veçantë, të cilët personifikohen me mjeshtëri nga autori.

Nëse do ta personifikojmë tani vetë autorin, me njohjen tonë jo të plotë dhe pa u njohur siç duhet me tërë opusin e tij, të cilin na e ka lënë si trashëgimi të çmuar të gjithë neve, bashkatdhetarëve të tij, mund të themi: Muhamet Kyçyiku është një njohës dhe zbatues i folklorit shqiptar jugor, i gjuhës dhe i stilit të poezisë popullore, i figurave stilistike, që të përdorura me mjeshtëri, i vesh personazhet si Jusufin, Zylihanë, Ervehën etj., i përdorimit të mënyrave mjeshtërore të dialektit çam në tërë pasurinë e tij, i futjes së gjuhës amtare si gjuhë mësimore, i shembullit të punës, të qytetarit, të edukatorit, të atdhetarit, të besimtarit mysliman.



*Të edukosh
një fëmijë*

Të vendosësh përkufizimin e edukimit në fillim apo në fund të diçkaje më duket sikur duhet ta zbrazesh atë gjë. Koncepte si 'edukim fetar', 'edukatë gjumi' apo 'edukatë tualeti', janë koncepte të cilat i trembin nënat dhe nxisin një proces jo shumë natyral. Më duket se edukimi është një koncept i arritur me disiplinë, kurorëzim i shumë provave, i papërshtatur ndonjëherë me vlerat tona, në shërbim të një lloji të vetëm, verbues i aftësive dhe talentit dhe një mundësi e humbur për të gjetur barazinë.

Gjatë edukimit të fëmijëve prindërit mbesin të pavendosur mes mësimit tradicional dhe informacionit të marrë nga librat. Dhe me këtë mendim përballemi me shumë nëna të cilat nuk arrijnë të shijojnë mëmësinë dhe fëmijët fëmijërinë e tyre. Nga ana formale edukimi është një kusht i rëndësishëm por këtu rëndësi ka mosha dhe koha. Sigurisht që nuk jemi kundër edukimit por kur themi edukimi i fëmijës më duket më e përshtatshme të përdorim fjalët 'program i edukimit të njeriut'.

Do të flasim për prindërimin natyral, pra për nënat dhe baballarët të ngarkuar me programin individual me anë të të cilit do të mund të rrisin e edukojnë emanetet e lëna në shtëpitë e tyre pa prishur modelet përkatëse.

Të ndihesh i mbrojtur dhe i sigurtë

Pa dyshim që nëna dhe babai janë faktorët më ndikues në formësimin e ndjenjave të fëmijëve. Sjellja e tyre përballë njëri-tjetrit, rolet që ata pasqyrojnë janë porsia fara të hedhura në botën e ndjenjave të fëmijëve. Këta fara janë aq të rëndësishme sa që ndikojnë në përzgjedhjet, botën shpirtërore dhe psikologjinë e fëmijës.

Rolet e dhëna si burrit ashtu edhe gruas nga Krijuesi ndihmojnë në qetësinë e harmoninë familjare dhe në rritjen e edukimin e fëmijës si një individ i dobishëm. Ndonjëherë mendojmë se këta role janë dhënë për të shtuar dashurinë dhe lidhjen mes dy partnerëve. Rolet më të brishta të një burri janë siguria, besnikëria ndërsa ato të një gruaje janë dhembshuria dhe respekti. Prandaj shpesh thuhet se fëmija merr dashurinë e dhembshurinë nga nëna dhe urtësinë e sigurinë nga babai.

Le të analizojmë pak ndjenjën e mbrojtjes

Lidhja dhe ndjesia e mbrojtjes janë ndjenja të cilat lindin me fëmijën dhe përbëjnë bazën e ndjenjave fetare më vonë. Fëmija ka nevojë të ndihet i mbrojtur, i sigurtë, të marrë dashurinë e dhembshurinë e personave më të fuqishëm se ai. Përsa kohë i plotësohen këta nevoja ai do të krijojë lidhje të shëndetshme me njerëzit përreth, me anë të kësaj lidhjeje ai kërkon ndjenjën e sigurisë.

Qëllimi final i të besuarit është lidhja dhe mbështetja tek dhuruesi i këtij besimi dhe sigurie. Kjo dëshirë për të krijuar lidhje të sigurta pasqyrohet edhe tek krijimi i besimit fetar. Të jesh i mbrojtur dhe të lidhesh me mbrojtësin vazhdon gjatë gjithë jetës së fëmijës duke u shfaqur në mënyra të ndryshme.

Ndjenja e lidhjes së sigurtë e cila përbën thelbin e jetës fetare ngjason shumë me lutjen për ndihmë apo mbrojtje

drejtuar Krijuesit të madhëruar. Pra në fillim fëmija gjen tek prindi mbrojtjen dhe sigurinë e dëshiruar ndërsa më vonë vitet në vazhdim këtë ndjenjë do ta plotësojë duke krijuar lidhje të forta me vetë Krijuesin.

Në fillim fëmija do ta shohë prindin e tij si i plotfuqishëm dhe një vend ku mund të gjejë siguri e dashuri por me kalimin e kohës ai do të kuptojë pamjaftueshmërinë e prindit. Në këtë rast do të ndjejë nevojën e lidhjes me një fuqi më të madhe se prindërit, ndjen nevojën e strehimit tek Ai. Nevoja e lidhjes me prindërit do ta drejtojë atë drejt Zotit (xh.sh). Në një fare mënyre prindërit shërbejnë për ta prezantuar fëmijën me Krijuesin.

Kur tek fëmija krijohet dëshira, ndjenja dhe mendimi fetar do të fillojë të kërkojë Zotin e madhëruar të cilit mund t'i besojë e mbështetet. Kjo ndjenjë është shumë e rëndësishme për zhvillimin fetar të individit në të ardhmen.

Të vlerësojmë ndjenjën e imitimit

Periodha e imitimit përfshin periudhën parashkollore 0-6 vjeç. Gjatë kësaj kohe fëmija imiton çdo gjë që sheh rreth e rrotull ngaqë nuk e koncepton mirë realitetin.

E bërë në mënyrë të pavetëdijshme dhe vetvetiu imitimi fillon në moshë të vogël. Reagimet, fjalët apo veprimet mekanike fillojnë të tregojnë veten. Lutjet apo vjershat e mësuara përmendësh nuk përmbajnë një kuptim të caktuar. Ky imitim i pavetëdijshëm dhe i shndërruar në refleks luan një rol thelbësor në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Prandaj është shumë e rëndësishme të kontrollojmë veten në fjalët, sjelljet apo reagimet e dhëna për një gjë. Fëmijët tanë janë një pasqyrim yni i qartë.

Zakonet e krijuara tek fëmija fillojnë duke imituar sjelljet e të rriturve. Fëmija është i prirur të përshtatet me pritshmëritë e rrethit. Prandaj të rriturit luajnë rolin thelbësor për të krijuar një model të mire nga ana fetare e morale. Ato duhet të mbajnë rolin e udhëheqësit, guides në këtë aspekt. Le të vlerësojmë aftësitë imituese të fëmijëve dhe të shpalosim më të mirën tonë.

Sigurisht që prirja e imitimit nuk vazhdon për një kohë të gjatë, në periudhën e adoleshencës nga faza imituese kalojmë në fazën vërtetuese. Shpirti kundërshtues i adoleshentit apo kritikimi igjërave të mësuara nga prindërit nuk është asgjë tjetër përveç gjendjes emocionale të ngarkuar dhe pasqyrim i një tranzicioni të njohur nga ndryshimi i moshës.

Periodha e fëmijërisë konsiderohet një periudhë dinamike përse i përket zhvillimit fetar. Fëmijët kanë një aftësi të paparë imitimi dhe prindërit apo drejtuesit e institucioneve fetare përbëjnë shembullin më të mire për ta. Sigurisht që imitimi luan një rol të rëndësishëm në këtë pike por nuk duhet të harrojmë dhe praktikën apo eksperiencën fetare të fëmijës.

Ndjenjat e përjetuara në periudha të ndryshme të jetës së fëmijës duhen vlerësuar si një mundësi e artë për edukimin e tyre shpirtëror.



Farmakokinetika

SI REAGON TRUPI YNË NDAJ NJË MEDIKAMENTI?

Kur marrim një recetë nga mjeku, ilaçi zakonisht vjen me udhëzime se si ta përdorim atë. Këto udhëzime përfshijnë kohën kur e marrim ilaçin (para ose pas vaktit), sa herë në ditë dhe për sa kohë e marrim atë dhe çfarë duhet të shmangim gjatë përdorimit të tij. Mjekët gjithashtu pyesin nëse përdorim ndonjë mjekim tjetër ose nëse kemi ndonjë sëmundje kronike përpara se të përshkruajmë ndonjë ilaç të ri. Shumica e ilaçeve duken të ngjashme, por vetë barnat mund të jenë shumë të ndryshme. A keni menduar se çfarë ndodh me një ilaç kur hyn në trupin tonë?

Të gjitha funksionet e trupit dhe proceset e sëmundjes si dhe shumica e reaksioneve të ilaçeve ndodhin në nivel qelizor. Barnat janë kimikate që ndryshojnë proceset bazë në qelizat e trupit. Ata nuk mund të shtojnë funksione dhe aktivitete, por mund të ndikojnë vetëm në funksionet dhe aktivitetet normale qelizore. Ilaçet e dhëna për efekte sistemike duhet të arrijnë përqendrimet adekuat në gjak dhe lëngjet e tjera të indeve që rrethojnë qelizat tona për të pasur një efekt. Barnat duhet të qarkullojnë nëpër trup, të arrijnë në qelizat e synuara dhe, pasi të prekin qelizat, të eliminohen nga trupi. Por si ndodhin të gjitha këto procese? Si arrijnë, ndërveprojnë dhe largohen medikamentet sistemike nga qelizat e trupit?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve marrin përgjigje nga një nga fushat kryesore të farmakologjisë - farmakokinetika. Farmakokinetika rrjedh nga fjalët greke *pharmakon* (ilac) dhe *kinetikos* (lëvizje) dhe do të thotë "ajo që trupi i bën një ilaçi". I referohet lëvizjes së një ilaçi brenda, përmes dhe jashtë trupit.

Njohja e parimeve farmakokinetike i ndihmon ofruesit e kujdesit shëndetësor të rregullojnë dozat në mënyrë më të saktë dhe më të shpejtë. Zbatimi i parimeve farmakokinetike për individualizimin e farmakoterapisë quhet monitorimi terapeutik i barnave dhe synon t'i japë çdo personi sasinë e saktë të barit.

Katër pjesët kryesore të proceseve farmakokinetike janë

Absorbimi
Shpërndarja
Metabolizimi
Eliminimi

Absorbimi

Absorbimi është procesi që ndodh kur një ilaç hyn në trup derisa të hyjë në qarkullimin e gjakut për të qarkulluar. Kohëzgjatja e veprimit të një ilaçi përcaktohet kryesisht nga shkalla e përthithjes, dhe intensiteti përcaktohet nga shkalla e përthithjes.

Faktorë të shumtë ndikojnë në shkallën e përthithjes së barit, duke përfshirë dozën, formën, rrugën e administrimit, rrjedhjen e gjakut në vendin e administrimit, funksionin gastrointestinal dhe praninë e ushqimit ose barnave të tjera.

Shumica e barnave orale duhet të gëlltiten, të treten në lëngun e stomakut dhe të dërgohen në zorrën e hollë (e cila ka një sipërfaqe të madhe për thithjen e lëndëve ushqyese dhe barnave) përpara se të përthithen. Ilaçet e lëngshme përthithen më shpejt se tabletat ose kapsulat, sepse nuk duhet të treten. Lëvizja e shpejtë përmes stomakut dhe zorrës së hollë mund të rrisë përthithjen e barit duke nxitur kontaktin me membranën mukoze absorbuese, gjithashtu mund të ulë përthithjen sepse disa barna mund të lëvizin nëpër zorrën e hollë shumë shpejt për t'u përthithur. Për shumë ilaçe, prania e ushqimit në stomak ngadalëson shkallën e përthithjes dhe mund të ulë sasinë e barit të përthithur. Kjo është arsyeja pse disa barna merren para ngrënies dhe disa pas.

Ilaçet nuk mund të përthithen mirë kur një pacient ka diarree dhe zorrët punojnë së tepërmi dhe efekti i barit do të reduktohet. Thithja mund të rritet nëse pacienti ka kapsllëk dhe zorrët punojnë shumë ngadalë, kjo mund të ketë efekte negative të paparashikuara.

Ilaçet e injektuara në indet nënlëkurore ose intramuskulare zakonisht absorbohen më shpejt se ilaçet orale, sepse ato lëvizin drejtpërdrejt nga vendi i injektimit në qarkullimin e gjakut. Thithja është e shpejtë nga vendet e muskujve sepse indet e muskujve kanë furnizim të bollshëm me gjak. Barnat e injektuara në mënyrë intravenoze (në vena) nuk kanë nevojë të përthithen sepse vendosen direkt në qarkullimin e gjakut.

Vende të tjera absorbuese përfshijnë lëkurën, mukozën dhe mushkëritë. Shumica e barnave të aplikuara në lëkurë jepen për efekte lokale (p.sh., kremrat relaksues të muskujve, pomadat për lehtësimin e kruajtjes dhe pomadat për djegien). Thithja sistemike është minimale nga lëkura e paprekur, por mund të jetë e konsiderueshme kur lëkura është e përflakur ose e dëmtuar. Gjithashtu, një sërë barnash janë formuluar në copa ngjitëse të lëkurës për përthithje përmes lëkurës. Disa barna të aplikuara në mukozë jepen gjithashtu për efekte lokale. Megjithatë, përthithja sistemike ndodh nga mukozat e zgavrës së gojës, hundës, syve etj. Barnat e absorbuara përmes mukozave kalojnë direkt në qarkullimin e gjakut. Për shembull, tabletat nëngjuhësore të nitroglicerinit përdoren për të trajtuar episodet e anginës (dhimbje gjoksi) te njerëzit që kanë sëmundje të arterieve koronare. Përdoret gjithashtu pak para aktiviteteve që mund të shkaktojnë episode të anginës për të parandaluar simptomat. Ajo funksionon duke relaksuar enët e gjakut, kështu që zemra nuk ka nevojë të punojë aq fort dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për aq shumë oksigjen. Mushkëritë mund të jenë një vend i mirë përthithjeje, pasi ato kanë një sipërfaqe të madhe për thithjen e gazeve anestezike dhe disa ilaçeve të tjera.



Shpërndarja

Shpërndarja përfshin transportin e molekulave të barit brenda trupit. Pasi një ilaç injektohet ose absorbohet në qarkullimin e gjakut, ai bartet nga gjaku dhe lëngjet e indeve në vendet e tij të veprimit farmakologjik, metabolizmit dhe sekretimit. Shumica e molekulave të barnave hyjnë dhe dalin nga qarkullimi i gjakut në nivel kapilar, përmes boshllëqeve midis qelizave që formojnë muret e kapilarëve.

Shpërndarja varet kryesisht nga përshtatshmëria e qarkullimit të gjakut. Barnat shpërndahen me shpejtësi në organet që marrin një furnizim të madh gjaku, si zemra, mëlçia dhe veshkat. Shpërndarja në organet e tjera të brendshme, muskujt, dhjamin dhe lëkurën zakonisht është më e ngadaltë.

Një faktor i rëndësishëm në shpërndarjen e barnave është lidhja me proteinat. Shumica e barnave formojnë një kompleks me proteinat e plazmës si albumina. Këto proteina veprojnë si bartës të barnave. Molekulat e barit të lidhura me proteinat e plazmës janë farmakologjikisht joaktive, sepse madhësia e madhe e kompleksit pengon daljen e tyre nga qarkullimi i gjakut përmes vrimave të vogla në muret e kapilarëve dhe arrijnë e vendeve të tyre të veprimit. Vetëm pjesa e lirë ose e palidhur e një ilaçi vepron në qelizat e trupit. Ndërsa ilaçi i lirë vepron në qeliza, ulja e niveleve të proteinave plazmatike shkakton lirin e një pjese të barit të lidhur.

Lidhja e proteinave lejon që një pjesë e dozës së barit të ruhet dhe të lirohet sipas nevojës. Disa barna gjithashtu ruhen në muskuj, dhjam ose inde të tjera të trupit dhe lëshohen gradualisht kur nivelet e barit në plazmë bien. Këta mekanizma ruajtjeje zvogëlojnë rrezikun e toksicitetit. Barnat që lidhen shumë me proteinat e plazmës ose ruhen gjerësisht në inde të tjera kanë një kohëzgjatje të gjatë veprimi. Kjo ndikon në frekuencën e marrjes së një medikamenti dhe kjo është arsyeja pse disa barna merren më shpesh.

Shpërndarja e barnave në sistemin nervor qendror (SNQ) është e kufizuar për shkak të barrierës gjak-tru, e cila përbëhet nga kapilarë me mure të ngushta dhe kufizon lëvizjen e molekulave të barit në indet e trurit. Kjo pengesë është krijuar për të vepruar si një membranë e përshtueshme në mënyrë selektive për të mbrojtur SNQ. Megjithatë, ajo gjithashtu mund ta bëjë më të vështirë terapinë me ilaçe për çrregullimet e SNQ, sepse ilaçet duhet të kalojnë nëpër qelizat e murit kapilar dhe jo ndërmjet qelizave. Si rezultat, vetëm barnat që janë të tretshëm në lipide ose kanë një sistem transporti mund të kalojnë barrierën gjak-tru dhe të arrijnë përqendrime terapeutike në indet e trurit.

Shpërndarja e barnave gjatë shtatzënisë dhe

laktacionit është gjithashtu unike. Gjatë shtatzënisë, shumica e barnave kalojnë placentën dhe mund të ndikojnë në fetus. Gjatë laktacionit, shumë ilaçe hyjnë në qumështin e gjirit dhe mund të ndikojnë tek foshnja në gji. Kjo pengesë është gjithashtu e rëndësishme dhe mbron fetusin nga efektet negative të barnave.

Metabolizimi

Metabolizimi është reaksioni kimik me të cilin ilaçet inaktivizohen ose bio-transformohen nga trupi. Më shpesh, një ilaç aktiv shndërrohet në një ose më shumë metabolitë joaktive, të cilët më pas ekskretohen. Disa barna aktive japin metabolitë që janë gjithashtu aktive dhe që vazhdojnë të ushtrojnë efektet e tyre në qelizat e trupit derisa ato të metabolizohen më tej ose të ekskretohen. Barnat e tjera (të quajtura prodroga) fillimisht janë joaktive dhe nuk ushtrojnë efekte farmakologjike derisa të metabolizohen.

Shumica e barnave janë të tretshme në lipide, një karakteristikë që ndihmon lëvizjen e tyre nëpër membranat qelizore. Megjithatë, veshkat, të cilat janë organet kryesore sekretuese, mund të nxjerrin vetëm substanca të tretshme në ujë. Prandaj, një funksion i metabolizmit është shndërrimi i barnave të tretshme në yndyrë në metabolitë të tretshëm në ujë.

Metabolizmi hepatic i barnave, ose pastrimi, është një mekanizëm kryesor për përfundimin e veprimit të barit dhe eliminimin e molekulave të tij nga trupi. Shumica e barnave metabolizohen nga enzimët në mëlçi, qelizat e kuqe të gjakut, plazma, veshkat, mushkëritë dhe mukozën gastrointestinale.

Me administrimin afatgjatë, disa barna stimulojnë qelizat e mëlçisë për të prodhuar sasi më të mëdha të enzimave metabolizuese të barnave (një proces i quajtur induksion i enzimës). Induksioni i enzimës përshpejton metabolizmin e barit sepse sasi më të mëdha të enzimave lejojnë që sasi më të mëdha të një ilaçi të metabolizohen gjatë një kohe të caktuar. Si rezultat, mund të nevojiten doza më të mëdha të barit të metabolizuar me shpejtësi për të prodhuar ose mbajtur efekte terapeutike. Metabolizmi gjithashtu mund të zvogëlohet ose vonohet në një proces të quajtur frenim enzimë, i cili më së shpeshti ndodh me administrimin e njëkohshëm të dy ose më shumë barnave që konkurrojnë për të njëjtat enzima metabolizuese. Në këtë rast, mund të nevojiten doza më të vogla të barit të metabolizuar ngadalë për të shmangur reaksionet anësore dhe toksicitetin

nga akumulimi i barit. Kështu, mjekët gjithmonë pyesin për ndonjë medikament tashmë të përdorur përpara se të përshkruajnë një ilaç të ri. Gjithashtu, disa ushqime (p.sh. grejpfrut), pije (alkooli) dhe pirja e duhanit ndikojnë në aktivitetin e enzimave që metabolizojnë barnat në mëlçi. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të ndjekim udhëzimet e mjekut gjatë përdorimit të ndonjë medikamenti.

Shkalla e metabolizmit të barnave është gjithashtu e reduktuar tek foshnjat (sistemi i tyre i enzimës hepaticë është i papjekur), te njerëzit me qarkullim të dëmtuar të gjakut në mëlçi ose sëmundje të rënda hepaticë ose kardiovaskulare, dhe te njerëzit që janë të kequshqyer ose me dieta me pak proteina. Metabolizmi tek të moshuarit dhe gratë shtatzëna gjithashtu ndryshon shumë, kështu, doza që i jepet çdo individ duhet të llogaritet me kujdes, veçanërisht te fëmijët, të moshuarit dhe gratë shtatzëna.

Ekskretimi

Ekskretimi i referohet eliminimit të një ilaçi nga trupi. Ekskretimi efektiv kërkon funksionimin adekuat të sistemit të qarkullimit të gjakut dhe të organeve të sekretimit (veshkat, zorrët, mushkëritë dhe lëkura). Shumica e barnave ekskretohen nga veshkat dhe eliminohen të pandryshuara ose si metabolitë në urinë. Disa barna ose metabolitë ekskretohen në rrugët biliare, pastaj eliminohen me feçet, riabsorbohen nga zorra e hollë, kthehen në mëlçi (i quajtur riqarkullim enterohepatik), metabolizohen dhe përfundimisht ekskretohen në urinë. Disa barna nga goja nuk absorbohen dhe ekskretohen me feçet. Mushkëritë largojnë kryesisht substancat e paqëndrueshme, si gazrat anestetikë. Lëkura ka një funksion minimal ekskretues. Faktorët që dëmtojnë ekskretimin, veçanërisht sëmundja e rëndë renale, çojnë në grumbullimin e barnave të shumta dhe mund të shkaktojnë efekte të rënda negative nëse doza nuk reduktohet. Mjekët gjithmonë pyesin për ndonjë sëmundje kronike përpara se të përshkruajnë ndonjë ilaç.

Procesi i zhvillimit të një ilaçi është i gjatë dhe i vështirë. Udhëzimet për përdorim vendosen pas shumë provash eksperimentale dhe klinike. Asnjë nga udhëzimet e dhëna me medikamente nuk vendoset në mënyrë të rastësishme, kështu, ne duhet të ndjekim plotësisht udhëzimet për të maksimizuar efektet pozitive të një ilaçi dhe për të shmangur çdo efekt të mundshëm negativ.

Përktheu: Erion Sukaj

BABAI DHE DJALI

Në një vend jetonte një baba me të birin. Të dy ishin të dijshtëm. Babai ishte punëtor e djali përtac.

Babai e nxiste djalin të punojë duke i treguar për pasojat e papunësisë dhe përtacisë, duke ia përkujtuar që Kur'ani udhëzon që të punojmë, duke na thënë: "Njeriut nuk i takon përveç asaj që ka punuar", dhe se nuk ka gjë më të mirë për njeriun se puna dhe përpjekja e tij. Ndërsa djali i përgjigjej se Allahu i Madhërishëm ia ka garantuar secilit rrëzkun me fjalët e Kur'anit: "Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu nuk ia ka garantuar furnizimin". Babai i tha se e dinte këtë ajet kuranor, por në pyetje është se çfarë nafake garantohet. Por djali edhe më tej ngulte këmbë në mendimin e tij.

Një ditë, djali shprehu dëshirën që të shëtiste nëpër botë dhe të provojë rrëzkun e tij. Erdhi në një vend që i pëlqeu, por pasi i shpenzoi të hollat dhe askush nuk e pranoi, vendosi të kthehet në shtëpi. Rugës për në shtëpi e zuri nata në një mal dhe djali u strehua në një shpellë. Në mëngjes, u zgjua herët dhe vërejti një dhelpër të sëmurë e cila mezi

arriti te shpella dhe aty u ndal, ngase nuk mundi të ecte më tutje.

Djali mendoi me vete: "Kjo dhelpër qenka e sëmurë dhe vetë nuk mund ta gjejë rrëzkun", dhe ngeci tri net për të parë si do të arrijë dhelpër te furnizimi.

Pas tri netësh, pa një ujë i cili mbante në dhëmbë një gjah të cilin e hodhi afër dhelpërës.

Pasi e hëngri të tërin i la vetëm eshtrat dhe shkoi. Dhelpër me mund duke u zvarritur shkoi deri te kockat dhe filloi t'i lëpijë e duke ngrënë ushqimin e saj.

Pas kësaj ndodhie, djali vazhdoi rrugën. Kur erdhi në shtëpi, babai e pyeti si kishte kaluar.

Djali ia tregoi ndodhinë e dhelpërës dhe ujkut duke theksuar që ai kishte të drejtë, që Allahu xh.sh. secilit ia ka garantuar rrëzkun, bile edhe dhelpërës së sëmurë. Babai iu përgjigj: "Ah djali im, është e vërtetë se Allahu secilit ia ka garantuar rrëzkun, por çfarë rrëzku? Ti e ke parë dhelpërën e sëmurë e cila pas tre ditësh, shijoi nga kockat e mbetura prej dikujt tjetër e përse nuk e vërejte, marre të qoftë, ujkun i cili e ushqeu veten por edhe tjetrit i la diçka?!".



Ramazan	Ditët	Prill Maj	*Agimi (Imsaku)	Lindja e Diellit	Dreka (Yleja)	Pasditja (Iqindia)	Perëndimi (Akshami)	Darka (Jacja)
1	SH.	2	04:43	06:18	12:51	16:24	19:13	20:37
2	D.	3	04:41	06:16	12:51	16:24	19:14	20:38
3	H.	4	04:39	06:15	12:51	16:24	19:15	20:40
4	M.	5	04:37	06:13	12:51	16:25	19:16	20:41
5	M.	6	04:35	06:11	12:50	16:25	19:17	20:42
6	E.	7	04:33	06:10	12:50	16:26	19:18	20:44
7	P.	8	04:31	06:08	12:50	16:26	19:19	20:45
8	SH.	9	04:29	06:06	12:49	16:26	19:20	20:46
9	D.	10	04:27	06:05	12:49	16:27	19:21	20:48
10	H.	11	04:25	06:03	12:49	16:27	19:22	20:49
11	M.	12	04:23	06:02	12:49	16:28	19:23	20:51
12	M.	13	04:21	06:00	12:48	16:28	19:25	20:52
13	E.	14	04:20	05:58	12:48	16:28	19:26	20:53
14	P.	15	04:18	05:57	12:48	16:29	19:27	20:55
15	SH.	16	04:16	05:55	12:48	16:29	19:28	20:56
16	D.	17	04:14	05:54	12:47	16:29	19:29	20:58
17	H.	18	04:12	05:52	12:47	16:30	19:30	20:59
18	M.	19	04:10	05:51	12:47	16:30	19:31	21:00
19	M.	20	04:08	05:49	12:47	16:30	19:32	21:02
20	E.	21	04:06	05:48	12:47	16:31	19:33	21:03
21	P.	22	04:04	05:46	12:46	16:31	19:34	21:05
22	SH.	23	04:02	05:45	12:46	16:31	19:35	21:06
23	D.	24	04:00	05:43	12:46	16:32	19:36	21:08
24	H.	25	03:58	05:42	12:46	16:32	19:37	21:09
25	M.	26	03:56	05:40	12:46	16:32	19:39	21:11
26	M.	27	03:55	05:39	12:45	16:33	19:40	21:12
27	E.	28	03:53	05:38	12:45	16:33	19:41	21:14
28	P.	29	03:51	05:36	12:45	16:33	19:42	21:15
29	SH.	30	03:49	05:35	12:45	16:33	19:43	21:17
30	D.	1	03:47	05:34	12:45	16:34	19:44	21:18

Oraret i referohen Tiranës.

Për zonat e tjera si vijon: Durrës +2', Shkodër +2', Vlorë +1', Lushnjë +1', Berat 0', Elbasan -1', Kukës -1', Peshkopi -2', Librazhd -2', Korçë -5'.

27.04.2022 (e mërkurë) - **Nata e Kadrif.**